



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

STRATEGJIA E RISHIKUAR PËR RI-INTEGRIMIN E PERSONAVE TË RIATDHESUAR

Prishtinë, Maj 2010

Lista e shkurtesave:	4
Hyrje	5
Rekomandimet e përgjithshme	6
Migrimi nga Kosova	7
Riatdhesimi jo i vullnetshëm	7
Riintegrimi	8
Korniza ligjore	8
1. Ndihma gjatë pritjes fillestare	9
1.1. Ndihma e afruar menjëherë pas arritjes	9
1.2. Transportimi i mëtejshëm deri në komunën e destinacionit	9
1.3. Akomodimi i përkohshëm (qendra transit)	10
1.4. Mekanizmat bashkërendues dhe referues në mes të MPMS-së dhe të MAPL-së (Komunat)	10
1.5. Shërbimet Shëndetësore pas arritjes	11
Rekomandimet:	11
2. Ri-integrimi ligjor i personave të riatdhesuar – qasja në dokumentet civile	11
2.1. Procedurat dhe dokumentacioni	12
a. Certifikata e Gjendjes Civile	12
b. Dokumentet e identifikimit (Letërnjoftimi) dhe Dokumentet e Udhëtimit	13
c. Njohja zyrtare e dokumenteve / Certifikatat e lëshuara në shtetet e kërkuese	13
3. Bashkërendimi me ministritë tjera	15
3.1. Pranimi në pikën e arritjes	15
Rekomandimet:	15
3.2. 3.2 Qasja në kujdesin shëndetësor	15
Rekomandimet	16
3.3. Punësimi	16
3.4. Politikat e punësimit	17
Politikat aktive të tregut të punës	17
Politikat pasive të tregut të punës	17
Rekomandimet	17
3.5. Arsimi	18
3.6. Infrastruktura shkollore	20
Rekomandimet	20
3.7. Mirëqenia Sociale	21
Skema e pensioneve bazike	21
Skema e pensioneve të aftësisë së kufizuar	22
Skema për familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme	22
Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe viktimave civile të luftës	23
Skema e ndihmës sociale (për familjet e varfra)	23
Skema e pensioneve të parakohshme të punëtorëve të kompleksit Trepça	23
Rekomandimet:	24
4. Grupet e pambrojtura	24
4.1. Viktimat e trafikimit	24
Rekomandimet:	26
4.2. Nënats vetë-ushqyese	26
Rekomandimet	26
4.3. Fëmijët pa përkujdesje familjare dhe fëmijët e braktisur	27
4.4. Fëmijët pa kujdes prindëror si dhe fëmijët e abuzuar dhe keqtrajtuar	27
4.5. Mbrojtja e fëmijëve me nevoja të veçanta	27
Rekomandimet:	27

4.6.	Personat e moshuar pa përkujdesje familjare	27
	Rekomandimet:	27
4.7.	Personat me aftësi të kufizuara mendore dhe pa përkujdesje familjare	27
	Rekomandime:	28
5.	Banimi dhe çështjet pronësore	28
5.1.	Korniza institucionale	29
5.2.	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	29
5.3.	Autoritetet Komunale	29
5.4.	Qiraja dhe politikat e qirasë në fushën e banimit	29
5.5.	Bashkëpunimi i MMPH-së me ministritë e linjës	30
5.6.	Agjencia Kosovare e Pronës	31
	Rekomandimet:	31
6.	Partneriteti dhe evidentimi i përgjegjësi në vijën horizontale dhe vertikale	32
6.1.	Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe ndalimi i praktikave diskriminuese	32
6.2.	Roli koordinues në raport me komunat	32
6.3.	Konkluzione dhe rekomandime në kuadër të bashkërendimit të aktiviteteve në mes të pushtetit qendror dhe atij lokal	33
7.	Mekanizmat Koordinuese për Implementimin e Strategjisë për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar	34
7.1.	Bordi Koordinues Ndërministror	34
7.3.	Sekretariati i Bordit Koordinues ndërministror	34

Lista e shkurtesave:

AKP – Agjencia Kosovare e Pronës
BE- Bashkimi Evropian
BKK- Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
DAC- Departamenti i Administratës Civile
DSHAM - Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim
KDR- Këshilli Danez për Refugjatë
KDS-Kujdesi Dytësor Shëndetësor
KE- Komisioni Evropian
KFOR-Forcat Ndërkombëtare/Militare në Kosovë
KPSH- Kujdesi Parësor Shëndetësor
KQKRC - Koordinator i Qendrës Komunale për Regjistrim Civil
KTS -Kujdesi Tretësor Shëndetësor
MAPL -Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal
MASHT - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MD - Ministria e Drejtësisë
MEF- Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MKK-Ministria për Komunitete dhe Kthim
MMPH - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB -Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS - Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale
MSH - Ministria e Shëndetësisë
NS – Ndihma Sociale
OJQ-Organizata Jo-Qeveritare
IOM- Organizata Ndërkombëtare për Migrim
OSBE-Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PSO-Procedurat Standarde të Operimit
QPK-Qendra e Përkohshme Kolektive
QKRC-Qendra Komunale për Regjistrim Civil
QPS – Qendra për Punë Sociale
RAE-Komuniteti Romë, Ashkali dhe Egjiptian
SNS- Skema për Ndihmë Sociale
TeR – Termat e Referencës
TVK-Trafikimi i Viktimave të Kosovës
UNDP-Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
UNHCR- Komisionari i Lartë për Refugjatë i Kombeve të Bashkuara
ZCN- Zyra Civile Ndërkombëtare
ZKB- Zyrtari Komunal për Bashkësi
ZKGJC-Zyra Komunale për Gjendje Civile
ZKK-Zyrtari Komunal për Kthim
ZKM-Zyra e Kryeministrit

Hyrje

Riintegrimi i personave të riatdhesuar, lind si rezultat i procesit të riatdhesimit dhe si i tillë paraqet një nga sfidat me të cilat ballafaqohet Kosova gjatë periudhës së pas luftës. Numri i kosovarëve të cilët kanë lëshuar Kosovën më herët, gjatë dhe pas luftës, ka qenë i konsiderueshëm dhe si pasojë shtetet tjera, posaçërisht shtetet e BE-së, nuk kanë qenë në gjendje të afrojnë vendbanim të përhershëm apo të përkohshëm në këto shtete. Leja e vendbanimit, qëndrimit apo qëndrimit të ligjshëm, iu është refuzuar një numri të konsiderueshëm të njerëzve nga kjo kategori, ku si pasojë është vendosur që këta persona të riatdhesohen.

Riatdhesimi në Kosovë ka ndodhur edhe para luftës së vitit 1999, sidoqoftë pas luftës ka ardh deri tek shtimi i numrit të personave që riatdhesohen dhe se ky trend është duke vazhduar gjer në ditët e sotme. Sipas statistikave zyrtare dhe të besueshme, mesatarja prej afër 5000 persona kanë qenë të riatdhesuar me forcë brenda një viti. Kjo paraqet mesataren vjetore të numrit të personave të riatdhesuar me forcë. Sidoqoftë duke pasur parasysh numrin e personave të cilët janë kthyer në Kosovë në baza vullnetare dhe PZHB, që janë kthyer në Kosovë, atëherë numri i përgjithshëm i personave të kthyer është më i madh, gjë e cila i shkakton ngarkesë shtesë mekanizmit për riintegrim dhe si rezultat ndikon edhe më tej në pamjaftueshmërinë e burimeve.

Përgjegjësia për riintegrimin e personave të riatdhesuar ka qenë deri vonë përgjegjësi e UNMIK-ut, UNHCR-së, IOM-it dhe organizatave tjera që kanë shqyrtuar këto raste. Në vitin 2006 kjo përgjegjësi iu është transferuar institucioneve kosovare, respektivisht Bordit Ekzekutiv i cili menaxhon implementimin e Strategjisë dhe Planit Veprues për riintegrimin e personave të riatdhesuar. Bordi ekzekutiv ka qenë i themeluar duke u bazuar në kërkesat që kanë rrjedh nga Strategjia për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, ku si përgjegjës për zbatimin strategjisë dhe planit të veprimit kanë qenë: MPB, MPMS, MAPL, MSH, MASHT, MAPH e po ashtu edhe Agjensionin Kosovar i Pronës për çështjet e lidhura me pronë. Këto institucione, gjatë viteve të kaluara kanë qenë të angazhuara për riintegrimin e personave të zhvendosur, sidoqoftë nuk ka ekzistuar një vlerësim i implementimit të kësaj strategjie dhe si pasojë ka lënë një hapësirë të zbrazët për interpretime të dyfishta të strategjisë dhe planit të veprimit.

Për këto arsye dhe me qëllim të sigurimit, që personat e zhvendosur të kenë tretman më të mirë pasi të riatdhesohen, Bordi Ekzekutiv ka vendosur të vlerësoj mekanizmin e tanishëm për riintegrim. Vlerësimi është bërë në bashkëpunim me akterët vendor dhe ndërkombëtarë, i bazuar në vendimin e Bordit Ekzekutiv i cili ka themeluar grupin punues të përbërë nga ekspertët vendor dhe ndërkombëtarë, në përpilimin e pyetësorit dhe si rezultat i kësaj ka analizuar përgjigjet e afuara nga ministritë.

Për fund është e udhës të ceket se procesi i ri-pranimit dhe i riintegrimit paraqet një pjesë të padiskutueshme që ndikon në procesin e liberalizimit të vizave. Veç kësaj, me adresimin e këtyre çështjeve do të zvogëlohet nevoja për emigrim ilegal e cila do ndikojë në hapjen e rrugës për emigrimin legal duke përfshirë emigrimin qarkullues.

Rekomandimet e përgjithshme

Bazuar në vlerësimin për riintegrimin e personave të riatdhesuar, kemi identifikuar disa rekomandime kyçe të cilat do të forcojnë dhe kontribuojnë në zbatim sa më të suksesshëm të strategjisë dhe planit të veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar. Duhet të ceket që kostoja financiare është identifikuar si sfida kryesore dhe bashkëpunimi i ngushtë me MEF dhe donatorët, e veçanërisht me vendet kërkuese. Ne po ashtu dëshirojmë të nënvizojmë rolin e shteteve kërkuese dhe i bëjmë thirrje për përkrahjen e tyre në përmbushjen e kësaj detyre të vështirë për Kosovën. Shtetet kërkuese duhet të afrojnë sa më shumë informata që është e mundur për numrin e personave që do të riatdhesohen, gjininë e tyre, përkatësinë etnike, grup moshën, komunat nga vijnë, shënimet shëndetësore, shënimet për vepra penale, të ju afrohen dokumente civil, në veçanti për fëmijët që kanë lindur në shtetet kërkuese duke përfshirë edhe ata që vijojnë mësimin. Ne jemi të vetëdijshëm se kjo mund të ndikojë në mbrojtjen e të dhënave, sidoqoftë ne nxisim që të ndërmerret një qasje praktike, qasje njerëzore.

Rekomandimet kyçe të identifikuara gjatë vlerësimit që dëshirojmë t'i cekim

janë:

- A. Hartimi dhe aprovimi i ligjit për riatdhesim dhe i gjendjës civile,
- B. Ndryshimi i strategjisë dhe plan veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar duke siguruar që rekomandimet nga ky vlerësim të mirren parasysh;
- C. Negocimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale për riatdhesim me BE-në (në bllok) apo individualisht me shtetet anëtare të BE-së;
- D. Themelimi i fondit inicial për riintegrimin e personave të riatdhesuar, i cili përbëhet nga buxheti i Konsoliduar Kosovës dhe donatorët e mundshëm;
- E. Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore në nivel qendror dhe lokal për të adresuar në mënyrë sa më efektive këtë proces.
- F. Përmirësimi i komunikimit dhe koordinimit ndër-institucional në nivel qendror dhe lokal me qëllim të eliminimit të mangësive.
- G. Përmirësimi i komunikimit me shtetet kërkuese, në veçanti shkëmbimi bilateral i informatave për personat potencial për riatdhesim në Kosovë.

Migrimi nga Kosova

Migrimi ka qenë dhe mbetet një dukuri e shkallës së lartë që radhit Kosovën në njërin prej vendeve të para të shteteve të origjinës së azilkërkuesve në shtetet e Bashkimit Evropian. Megjithatë, nuk ka analiza dhe raporte të mjaftueshme për këtë çështje. Mungesa e numrit të saktë të kosovarëve që jetojnë jashtë Kosovës ndodh për faktin se ata janë të regjistruar si qytetarë të Serbisë (Serbisë dhe Malit të Zi, ish- Jugosllavisë), pastaj është vështirë të identifikohen personat që kanë hyrë dhe që kanë qëndruar në ndonjë vend në mënyrë joligjore ose personat që nuk kanë status ligjor.

Trendët dhe shkaktarët e migrimit nga Kosova kanë ndryshuar. Në dekadat deri në shpërthimin e luftës në vitet 1998/1999, kosovarët, kryesisht shqiptarët e Kosovës, gjithashtu edhe një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të bashkësive tjera etnike janë larguar nga Kosova kryesisht për dy arsye: për shkaqe politike, veçanërisht në vitet 90-ta dhe për shkaqe socio-ekonomike. Gjatë luftës së fundit përpos zhvendosjes së qytetarëve brenda territorit të Kosovës, qindra mijëra njerëz u detyruan të largohen nga Kosova, fillimisht u strehuan në Shqipëri dhe Maqedoni por që shumica e tyre janë kthyer në ndërkohë. Sidoqoftë, një numër i madh gjeti strehim në vendet e Evropës Perëndimore, përfshirë këtu edhe pjesëtarët e komunitetit RAE, boshnjakë dhe goranë.

Shumë nga ata që janë larguar nga Kosova prej fillimit të viteve 90-ta ose kanë fituar statusin e refugjatit ose kanë fituar mbrojtjen në bazë të legjislacionit të vendeve kërkuese për moskthimin e tyre dhe u është dhënë e drejta e qëndrimit në vendet ku janë vendosur. Ata që nuk e kanë fituar statusin e refugjatit ose atyre që iu ka përfunduar ose anuluar statusi ligjor (mbrojtja e përkohshme) janë në gjendje kur do të duhet të largohen nga vendet mikpritëse. Prandaj ata ose kthehen vullnetarisht (me paketa të veçanta të ndihmës për tu kthyer, e cila ofrohet nga disa vende evropiane) ose kthehen në mënyrë të detyruar.

Me ndryshimin e politikave të migrimit nga shtetet perëndimore, me ç'rast migrantëve iu kufizohet e drejta për qasje në tregun e punës dhe si pasojë, në vitet e fundit janë riatdhesuar në mënyrë të detyruar (depërtuar) një numër i madh i migrantëve nga Kosova.

Riatdhesimi i detyruar

Personat pa status legal jashtë vendit janë ata persona të cilit nuk i kanë përmbushur apo nuk i përmbushin më kushtet e qëndrimit në territoret e shteteve tjera, meqë ata:

- Kanë hyrë atje ilegalisht,
- E kanë tejkaluar afatin e qëndrimit apo i ka përfunduar leja e qëndrimit,
- Iu është refuzuar përfundimisht kërkesa për azil, si dhe
- Iu është anuluar leja e qëndrimit- për shkaqe të aktiviteteve kriminale apo për shkaqe tjera (*persona non grata*).

Një numër i konsiderueshëm i kosovarëve jashtë vendit janë pa status legal. Atyre iu është mohuar statusi i refugjatit apo ndonjë tjetër status legal në një shtet mikpritës. Të gjithë kanë kaluar përmes procesit administrativ apo gjyqësor që ka rezultuar me urdhëresa zyrtare / vendime gjyqësore për të lëshuar shtetin. Pas shpalljes së pavarësisë dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përgjegjësitë për çështjet e

riatdhesimit janë bartur në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përderisa riintegrimi i këtyre personave është përgjegjësi ndër-ministrore. Gjatë kësaj periudhe, Qeveria e Kosovës ka nënshkruar marrëveshje bilaterale të riatdhesimit me Francën, Gjermaninë, Shqipërinë dhe Zvicrën përderisa me Belgjikën është nënshkruar protokoll i bashkëpunimit për ripranim. Gjithashtu, janë në proces të negocimit marrëveshjet e kësaj natyre me të gjitha shtetet Evropiane të cilat kanë përfaqësi diplomatike në Kosovë. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të tregoj gatishmëri për të nënshkruar marrëveshje edhe me vendet tjera, përderisa e drejta për kthim vullnetar të çdo personi nuk do t'i mohohet, nëse vendimi i tij/saj është bërë lirshëm.

Riintegrimi

Janë disa përkufizime të cilat shfrytëzohen për ta definuar riintegrimin e personave të riatdhesuar, sidoqoftë, Strategjia për riintegrimin e personave të riatdhesuar i referohet përkufizimit të IOM, i cili cekë se "riintegrimi i personave të riatdhesuar është ri-përfshirja apo ri-inkorporimi i personit në grup apo në proces p.sh. i ndonjë emigranti në shoqërinë e vendit të tij të origjinës. Arritja e kthimit të qëndrueshëm nënkupton mundësinë që për personin e riatdhesuar të sigurohen kushte politike, ekonomike dhe sociale për të ruajtur jetën, mënyrën e jetesës dhe dinjitetin. Ky është një proces i cili iu mundëson të kthyerve të rimarrin sigurinë fizike, sociale, ligjore dhe materiale për zhvillimin e jetës, mënyrës së jetesës dhe dinjitetit i cili nënkupton zhdukjen e diverzitetëve (dallimeve) evidente me shtetasit e vet.

Korniza ligjore

Konventat ndërkombëtare, standardet e BE-së dhe legjislacioni ekzistues vendor janë bazë e këtij dokumenti dhe duhet të respektohen gjatë zbatimit të Strategjisë dhe planit të veprimit. **Shtojca A** përmban listën e dokumenteve ligjore si dhe konventave që kanë të bëjnë me ri-integrimin e personave të riatdhesuar.

1. Ndhimja gjatë pritjes fillestare

1.1. Ndhimja e afruar menjëherë pas arritjes

Pasi t'i kenë kaluar procedurat e kontrollit kufitar, të gjithë personat e kthyer fillimisht priten dhe marrin informacion ndihmës nga zyrtarët e institucioneve vendase në Aeroportin e Prishtinës dhe në pikat tjera kufitare sipas nevojës.

MPMS-ja duhet të njoftohet nga MPB-ja për nevojat e personave të riatdhesuar përmes një njoftimi të parakohshëm (së paku 3 deri në 4 ditë pune para arritjes në aeroport). Kjo gjë u mundëson zyrtarëve të MPMS-së që të jenë të pranishëm kur të arrijnë të kthyerit dhe në këtë mënyrë t'ju afrojnë një pritje dhe të sigurojnë informata ndihmëse pasi ata t'i kenë kaluar procedurat e imigrimit.

Të kthyerve u afrohen informatat më të reja dhe broshura, të cilat përmbajnë një pasqyrë të shërbimeve themelore që ofrojnë në territorin e Kosovës dhe në komunën e destinacionit të tyre.

Ekipi pritës i MPMS-së do të mbaj shënime mbi të dhënat e përgjithshme statistikore për destinacionet e të kthyerve si dhe mbi kushtet mjekësore apo nevojat e posaçme të shfaqura nga të kthyerit pas kthimit në Kosovë. Gjithashtu, MPMS duhet të ketë një bazë të të dhënave e cila përmban të dhënat e nevojshme për personat e riatdhesuar dhe të cilat shpërndahen tek institucionet përkatëse.

MPMS-ja do ta informoj Zyrën/zyrtarin përgjegjës në MSH për aktivizimin e ekipit mjekësor në mënyrë që t'ju afrojnë ndihmën e menjëhershme mjekësore personave të kthyer në nevojë aty për aty në aeroport dhe në pikat tjera kufitare sipas nevojës, si dhe të aranzhojë hapat e tjerë të nevojshëm. Po ashtu në aeroport apo në pikat kufitare të Republikës së Kosovës duhet të jetë i pranishëm edhe një ekip lëvizës i mjekëve dhe i infermiereve për të ndihmuar ata persona të kthyer që kanë nevojë për ndihmë mjekësore, gjithnjë në koordinim të ngushtë me zyrtarët e MPMS-së. Në raste të veçanta, për personat e kthyer me sëmundje serioze, MSH-ja duhet të informohet paraprakisht nga zyrtarët e MPMS-së në mënyrë që të sigurojë afrimin e ndihmës së nevojshme për këta persona. MSH duhet të caktoj pikë kontakti për këtë çështje.

Zyrtarët përgjegjës të MPMS-së takohen me të kthyerit dhe vërtetojnë nëse ata persona kanë nevojë për transport apo strehim të përkohshëm. Ata do t'i shfrytëzojnë të dhënat personale të personave të kthyer, të afuara nga MPB-ja dhe do të mbledhin informacione tjera përkatëse për nevojat e posaçme për ndihmë në komunën e destinacionit të tyre në mënyrë që ta lehtësojnë riintegrimin e tyre.

1.2. Transportimi deri në komunën e destinacionit

Në mënyrë që t'u mundësohet personave të kthyer që në të njëjtën ditë të arrijnë në shtëpitë e tyre, MPMS-ja do ta organizojë transportin deri në komunat e destinuarat për ata të kthyer të cilët nuk kanë ndonjë mjet tjetër transporti. Transportimi i mëtejshëm mund të bëhet nga kombibus dhe autobusë në gjendje gatishmërie, pagesa bëhet vetëm pas shfrytëzimit të shërbimeve të tyre. Zgjidhje të tjera mund të gjinden dhe të diskutohen më tej me Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

Qeveria e Republikës së Kosovës përmes mekanizmave përkatës institucional duhet të monitoroj dhe përcjell çfarëdo incidenti të mundshëm, qasje në lirinë e lëvizjes, dhe qasje në transport të sigurt për personat që i takojnë komuniteteve pakicë në komunën e origjinës.

Në rastet kur evidentohen incidente që pengojnë lirinë e lëvizjes apo qasje në transport të sigurt për personat që i takojnë komuniteteve pakicë në komunën e origjinës, institucionet përkatëse do të merren me hetimin e rastit, do të ndërmarrin masa konkrete dhe do të përkushtohen në parandalimin e rasteve të tilla në të ardhmen.

1.3. Akomodimi i përkohshëm (qendra transit)

Për të kthyerit në gjendje të rëndë si dhe për ata persona të cilët nuk mund të shkojnë të njëjtën ditë në destinacionin e tyre përfundimtar, MPMS-ja siguron akomodimin e përkohshëm të tyre. Normalisht, afrimi i akomodimit të përkohshëm për të kthyerit nuk mund të bëhet për një periudhë më të gjatë se shtatë ditë. Por, në raste të veçanta kur personat e riatdhesuar nuk kanë vende të banimit, atëherë atyre duhet gjendet një zgjidhje më afatgjate e cila mund të rregullohet me skemën e qiradhënies. MPMS-ja do të krijoj dhe administroj një qendër transit për akomodimin e të riatdhesuarve.

Ekipi mjekësor i MSH-së do të kujdestarohet në mënyrë që t'i ndihmojë të kthyerit që kanë nevojë për kujdes mjekësor brenda qendrës transit. Në rast të të kthyerve me nevoja të posaçme të kujdesit mjekësor, aranzhimet e posaçme mund të bëhen nga ana e ekipit mjekësor dhe të komunës së destinacionit, ashtu që të jenë të gatshëm për afrimin e kësaj ndihme në raste të veçanta.

Lidhur me arritjen e personave të kthyer që akomodohen përkohësisht, MPMS-ja do t'i informojë me kohë komunat e destinacionit përmes personit të caktuar kontaktues të MAPL-së në mënyrë që t'ju mundësoj komunave gjetjen e një zgjidhjeje për ta, gjatë periudhës derisa të kthyerit të jenë të akomoduar në qendrën transit.

1.4. Mekanizmat bashkërendues dhe referues në mes të MPMS-së dhe të MAPL-së (Komunat)

Për çdo javë MPMS-ja e informon personin kontaktues për kthim nga radhët e MAPL-së mbi numrin e personave të riatdhesuar si dhe për nevojat e tyre.

Në veçanti, MPMS-ja e informon personin kontaktues nga MAPL-ja lidhur me këto gjëra:

- 1) Numrin e të kthyerve që kanë arritur si dhe komunat e tyre të destinacionit;
- 2) Numrin e familjeve dhe përbërjen e tyre (sa fëmijë, moshë e tyre, pleq, persona me aftësi të kufizuara, etj.);
- 3) Numri dhe lloji i nevojave të posaçme tashmë të identifikuar menjëherë pas arritjes;
- 4) Numri i të kthyerve që tashmë kanë arritur në komunën e destinacionit të tyre;
- 5) Numri i të kthyerve që kanë nevojë për riparim të shtëpive, duke specifikuar nëse të tillët tashmë kanë arritur në komunat e destinacionit të tyre apo janë vendosur në qendrën transit. Në disa raste, MPMS-ja nuk do të jetë në gjendje që të afrojë këtë lloj të informacionit, pasi që të kthyerit do të marrin vesh vetëm pas arritjes së tyre në shtëpi se për çfarë riparimi do të kenë nevojë. Në raste të tilla,

shërbime të duhura referimi do të vihen në funksion nëpër komunat e destinacionit;

- 6) Numri i të kthyerve të akomoduar në qendrën transit (të cilët për këtë arsye kanë nevojë për ndihmë të akomodimit social nga ana e komunës, apo për riparim të shtëpisë, nëse dihet lloji i riparimit) duke specifikuar komunën e tyre të destinuar.

1.5. Shërbimet shëndetësore pas arritjes

MSH-ja në bashkëpunim me autoritetet lokale do të siguroj praninë e saj në të gjitha pikat e hyrjes të personave të kthyer.

1. Me zyrtarin kontaktues (preferohet të jetë një Zyrtar Koordinues për disa Ministri) i cili do të bënte shpërndarjen e informatave personale për të gjithë të kthyerit;
2. Me ekipet mobile të cilat do të afronin shërbime në vend arritjen e të kthyerve por njëherësh do të bëjnë përcaktimin e personave me probleme shëndetësore, si dhe të transportonin të sëmurët e rëndë apo personat me nevoja speciale në institucionet shëndetësore përkatëse.
3. Me inspektorë sanitarë të cilët do të përkujdesen për kushtet higjienike dhe sanitare dhe çështjet nën kompetenca të tyre.

Rekomandimet:

MSH-ja, autoritetet lokale, MPMS-ja duhet të bëjnë këto gjëra:

- Të caktojnë zyrtarë që do të jenë përgjegjës për koordinimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me çështjen e riatdhesimit në institucionet përkatëse.
- MSH-ja të identifikoj dhe të përgatis listën e udhëzimeve shëndetësore (USH) që do të siguronin shërbimet urgjente mjekësore.
- Të marrin masat e nevojshme epidemiologjike dhe kundër-epidemiologjike.
- MPMS-ja dhe MAPL-ja do të punojnë së bashku në mekanizmat referues përmes Zyrtarëve Komunal për Kthim dhe Zyrtarëve Komunalë për Komunitete dhe përmes Qendrave për Punë Sociale.

2. Ri-integrimi ligjor i personave të riatdhesuar – qasja në dokumentet civile

Integrimi ligjor (regjistrimi dhe dokumentacioni)¹ është një element kritik dhe obligim ligjor në sigurimin e qasjes në shërbimet themelore dhe civile dhe të drejtat sociale të një individi. Duhet të merret parasysh që disa nga personat e riatdhesuar nuk kanë qenë kurrë përpara të regjistruar te autoritetet përgjegjëse në Kosovë² dhe për këtë arsye nuk do të posedojnë asnjë dokument që kërkohet për një qasje të menjëhershme dhe të pamohueshme në të drejtat themelore pas kthimit.

Për të adresuar çështjen e jo-regjistrimit/dokumentacionit në një fazë më të hershme, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), duhet të vlerësojë nevojën e regjistrimit/dokumentacionit qysh në procesin e ri-atdhesimit, si pjesë e procedurës së

¹ Regjistrimi i gjendjes civile dhe regjistrimi i vendbanimit

² Zyret Komonale për Regjistrim Civil (regjistrimi mbi gjendjen civile dhe certifikatat) dhe Qendrat Komonale për Regjistrim (regjistrimi i vendbanimit, dokumentet personale).

verifikimit kur shteti kërkues jep dëshmi të dokumentuara si provë e lidhjes së personit të riatdhesuar me Kosovën.

Për të asistuar personat pa dokumente personale për riatdhesim, autoritetet përgjegjëse duhet të zhvillojnë një broshurë informative shumë-gjuhësore me informata relevante dhe të lehta për përdorim (një qasje hap pas hapi) rreth institucioneve, vendit (ku) dhe procedurave (si) përmes të cilave personat e riatdhesuar mund të regjistrojnë gjendjen e tyre civile dhe vendbanimin para ose pas kthimit në Kosovë. Ky informacion duhet të botohet në të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovë dhe nëse është e mundur edhe në ndonjë gjuhë tjetër sipas nevojës. Broshura informative duhet të shpërndahet në vendet kërkuese qysh para se të ndodh riatdhesimi.

Përveç kësaj, autoritete përgjegjëse duhet të sigurohen që personat e riatdhesuar të marrin informacione në të gjitha gjuhët zyrtare në lidhje me rëndësinë e regjistrimit/dokumenteve dhe procedurave që do t'ju mundësojnë atyre qasje në regjistrim. Kjo mund të bëhet edhe gjatë kontrollit kufitar të zhvilluar menjëherë pas kthimit në Kosovë. Kjo ka rëndësi të veçantë për grupet që janë veçanërisht të rrezikuara nga përjashtimi social dhe marginalizimi, siç janë pjesëtarët e komunitetit RAE, për më tepër kur ata kthehen pas disa vitesh qëndrimi jashtë vendit.

Një aspekt i rëndësishëm i integritetit ligjor do të jetë regjistrimi i gjendjes civile dhe dokumentimit të të kthyerve, të cilët nuk kanë qenë të regjistruar më parë në Kosovë.

Autoritetet përgjegjëse duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë gjithashtu edhe dokumentacionit të fëmijëve të lindur jashtë vendit, të cilët ende nuk janë regjistruar nga autoritetet në Kosovë. Shtetet kërkuese, duhet t'i pajisin me certifikata adekuate të gjendjes civile dhe dokumentacion personal. Në raste të tilla, autoritetet përgjegjëse për ri-pranim duhet të sigurojnë brenda negociatave bilaterale me shtetet kërkuese që dokumentet e nevojshme, tanimë janë dhënë brenda procesit të ri-atdhesimit.

2.1. Procedurat dhe dokumentacioni

Dokumentet në vijim u janë dhënë personave nga Kosova:

a. Certifikata e Gjendjes Civile

Mungesa e dokumenteve personale mbetet shqetësim në Kosovë, pasi që një numër i madh i personave janë zhvendosur me dhunë gjatë luftës në vitin 1999 duke lënë prapa gjërat që iu përkisnin, përfshirë dokumentet e tyre të identifikimit. Për më tepër, shumë libra amë komunale janë zhdukur ose ishin shkatërruar, kështu duke vështirësuar funksionimin e gjendjes civile.

Shumë të riatdhesuar kanë jetuar për dhjetë apo më shumë vite në shtete të huaja para se kërkesa e tyre për azil ishte refuzuar. Kanë ndodhur lindje dhe martesat dhe janë regjistruar në vendet tjera. Nëse personat e riatdhesuar dështojnë të sjellin me vete dokumentet e huaja për të verifikuar këto ngjarje ata nuk do të mund të regjistrojnë fëmijët e tyre ose martesat pas arritjes në Kosovë. Kjo çështje duhet të adresohet gjatë negociimit të marrëveshjeve bilaterale me shtetet kërkuese.

Mungesa e dokumenteve personale është më kritike për pjesëtarët e grupeve të minoriteteve, të cilët kanë jetuar në strehimore jo formale dhe nuk kanë qenë të regjistruar në ndonjë zyrë komunale të gjendjes civile që ka operuar nën regjimin jugosllav para

zhvendosjes së tyre. Mungesa e çfarëdo dokumenti të vjetër ose një adresë e përhershme në Kosovë do të rezultojë diskualifikimin e tyre për përfitime sociale. Ajo mund t'ua pamundësojë qasjen në arsimim dhe punësim dhe do të bëhet një pengesë e vërtetë në ri-integrimin e grupeve të minoriteteve.

Zyrat komunale të gjendjes civile duhet të regjistrojnë çdo person të riatdhesuar përmes sistemit aktual, ashtu siç parashihet me legjislacionin në fuqi. Komunitat duhet të lëshojnë dokumente personale, certifikata të lindjes, certifikata të martesës, certifikata për shtëpi të përbashkët dhe mbajtje të familjes, certifikata që personi është në jetë, certifikata të gjendjes martesore dhe certifikata të vdekjes, përmes zyrave të gjendjes civile. Këto dokumente të gjendjes civile shërbejnë si parakusht për qasje në shërbimet e tjera komunale. Kështu që, pushteti qendror duhet të miratojë Ligjin për Gjendjen Civile i cili do të mundësojë një fleksibilitet më të madh në regjistrimin e rasteve të gjendjes civile të personave të riatdhesuar.

Për zbatimin e legjislacionit, MPB-ja në bashkëpunim me MAPL-në, do t'ju jap udhëzime autoriteteve lokale përgjegjëse që të lehtësojnë qasjen në dokumentet e gjendjes civile për personat e riatdhesuar.

Certifikatat e gjendjes civile që lëshohen nga ZKGC-të përfshijnë, por nuk kufizohen në certifikatat që konfirmojnë lindjen, martesën, vdekjen, statusin martesor, që dëshmojnë që personi është gjallë, për shtëpi të përbashkët dhe përkrahje familjes e të tjera. Procedurat e nxjerrjes së këtyre dokumenteve janë dhënë në aktet ligjore të lartë përmendura.

Qasja e Dokumenteve mbi Gjendjen Civile nga Personat e Riatdhesuar

Në vitin 2003, Departamenti i Gjendjes Civile ka lëshuar një memorandum me të cilin ka udhëzuar komunitat të themelojnë borde ankesash për t'u mundësuar të kthyer pa dokumente të aplikojnë për qasje në dokumentet e gjendjes civile. Komunitat kanë krijuar një bord të përbërë nga tre (3) anëtarë të bordit në secilën komunë për të vendosur mbi aplikacionet për regjistrim të vonë dhe të kthyer pa dokumente. Këto borde përdoren gjithashtu nga personat e riatdhesuar të cilët nuk kanë dokumente të gjendjes civile. Njëkohësisht, në kuadër të MPB-së egziston Divizioni për Shërbime dhe Ndhimë Juridike në kuadër të ARC-së, i cili merret me shqyrtimin e ankesave të refuzuara nga Bordi Komunal.

b. Dokumentet e identifikimit (Letërnjoftimi) dhe Dokumentet e Udhëtimit

Shtetasit e Kosovës mund të aplikojnë për tu pajisur me dokument identifikimi (letërnjoftim) dhe pasaportë të Republikës së Kosovës. Informatat në lidhje me procedurat e aplikimit janë të përcaktuara sipas Ligjit për Letërnjoftim Nr. 03/L-099 dhe Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit Nr. 03/L-037 si dhe Udhëzimet Administrative që burojnë nga këto ligje. Këto informacione mund të merren në Qendrat Komunale të Regjistrimit Civil si dhe në faqen e internetit të MPB-së. Disa nga këto ligje janë në fazën e plotësimit/ndryshimit që pritet të miratohen së shpejti nga Kuvendi i Kosovës.

c. Njohja Zyrtare e Dokumenteve / Certifikatat e lëshuara në shtetet e kërkuese

Njohja zyrtare e dokumenteve të rëndësishme të lëshuara nga ndonjë shtet tjetër është element kritik i një re-integrimit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar. Më të rëndësishmet janë:

- Certifikatat shëndetësore;
- Dokumentet që kanë të bëjnë me të drejtën për punësim dhe pension (p.sh. librezat e punës) dhe
- Certifikata e shkollimit dhe diplomat/Certifikatat tjera akademike.

3. Bashkërendimi me ministritë tjera

DSHAM-ja do të jetë përgjegjëse për ndarjen e rasteve të aprovuara të riadhesimit sipas komunave të origjinës dhe të informojë policinë kufitare dhe ministritë e përfshira në procesin e re-integrimit për numrin e rasteve individuale për secilën komunë, duke përfshirë të dhënat themelore, datën dhe vendin e arritjes, si dhe nevojat e veçanta të të kthyerve. DSHAM-ja do të zhvillojë një formë të veçantë që përmban këto informata. MAPL-ja pastaj do t'ia përcjell këta formularë komunës pranuese. MAPL-ja duhet të ketë zyrë të veçantë që do të mirret me çështjet e riadhesimit.

3.1. Pranimi në pikën e arritjes

Stafi i DSHAM-së duhet të jetë prezent në pikat e kalimit kufitar sapo të ketë arritur personi i riadhesuar. Ata e konfirmojë arritjen e të kthyerve të pritur me njoftime të mëhershme. Rastet e të kthyerve të pa lajmëruar do të refuzohen nga policia kufitare.

Në kufi, policia kufitare në bashkëpunim me DSHAM-në do t'ju jap personave të riadhesuar informata në lidhje me dokumentet civile.

Rekomandimet:

- MPB-ja u jep personave të riadhesuar broshura në gjuhët zyrtare, ku cekën informacione të nevojshme se si të merren dokumentet civile.
- MPB-ja duhet t'ju mundësoj të marrin dokumente civile personave të cilët nuk posedojnë asnjë dokument, veçanërisht grupet e minoriteteve.
- MPB-ja si autoriteti i ripranimit, duhet të siguroj dhënien e dokumentacionit të nevojshëm sipas procedurave të ripranimit.
- Duhet të hartohen dhe miratohen TeR për bordet e ankesave për rastet e personave pa dokumentacion.

3.2. 3.2 Qasja në kujdesin shëndetësor

Që nga mbarimi i luftës në Kosovë para 11 vitesh sistemi shëndetësor në Kosovë ka ndryshuar shumë. Strukturat dhe institucionet e gjithë sistemit shëndetësor i janë nënshtruar një rehabilitimi dhe rindërtimi mjaft të madh.

Ministria e Shëndetësisë (MSH) pas asaj periudhe, ka përpiluar dokumentet themelore me qëllim të organizimit të një sistemi shëndetësor i cili do të përmbushë standardet e sistemeve të Bashkimit Evropian. Legjislacioni, politikat dhe strategjitë e MSH-së bazohen në parimet e barazisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë.

Për të përmbush nevojat e qytetarëve të saj, MSH-ja edhe pse me resurse shumë të limituara, por me ndihmën e madhe të bashkësisë ndërkombëtare, ka zhvilluar një rrjet të gjerë të institucioneve shëndetësore, i cili siguron qasje të lehtë për të gjithë qytetarët e saj. Në këtë drejtim MSH-ja ka ndihmuar aktivisht, duke mbështetur programet e OQ/OJQ të cilat kanë adresuar probleme të veçanta të këtyre grupeve (viktimize të trafikimit, personave me aftësi të kufizuara, etj.)

Gjithsesi, sfidat e MSH-së në të ardhmen mbetin ngritja e burimeve njerëzore në lëmi të veçanta si edhe zhvillimi i shërbimeve shëndetësore të cilat duhet të adresohen në të

ardhmen. Pastaj, për të përmbush detyrimet e saj ndaj Personave të Riatdhesuar (PeR), MSH do të ketë nevojë për alokimin e mjeteve të duhura financiare.

Vëmendje e posaçme duhet kushtuar personave të riatdhesuar, veçanërisht atyre që vuajnë nga sëmundje serioze. Kjo bëhet më problematike në Kosovë për shkak të mungesës së shërbimeve adekuate në Kosovë. Për shkak të rrethanave (mungesës së pajisjeve, kornizave joadekuate) një numër i shërbimeve mjekësore terciare (kardiokirurgjia, onkologjia, poli traumatologjia, transplantimet (veshkë), çrregullimet mendore, etj) nuk mund të afrohen në Kosovë. Prandaj në vitin 2003 MSH-ja lansoi programin për trajtim mjekësor jashtë vendit. Deri më tani një numër i konsiderueshëm i kosovarëve ka përfituar nga ky program ndonëse numri i kërkesave është shumë më i madh. Meqenëse buxheti i MSH-së është i vogël, ndihma e afruar nga OQ/OJQ/KFOR-i është parë si e mirëseardhur.

Kapacitete të mjaftueshme për trajtim mjekësor do të afrohen për të gjithë personat që do të trajtohen në Kosovë. Personat me të meta mendore do të trajtohen në institucionet e themeluara për këtë qëllim.

Edhe grupeve të minoriteteve duhet t'u kushtohet kujdes i veçantë nga MSH-ja. Të gjithë personat e riatdhesuar do të marrin broshurat, ndërsa informata shitesë për çështjet shëndetësore do të afrohen nga personat përgjegjës në nivel lokal dhe atë qendror përmes fushatave publike si edhe në institucionet shëndetësore.

Gjatë periudhës së ri-integrimit, personat e riatdhesuar do të regjistrohen në institucionet shëndetësore dhe do të marrin kartela shëndetësore, dhe kështu do të hyjnë në sistemin e informimit shëndetësor. Me krijimin e sigurimit shëndetësor ata si edhe të gjithë qytetarët e tjerë do të hyjnë në këto skema dhe do të pajisen me dokumentet e duhura.

Deri në integrimin e tyre të plotë dhe varësisht nga statusi i tyre social ata do të janë të përjashtuar nga pagesat për shërbime shëndetësore.

Rekomandimet

- Ministria e Shëndetësisë duhet të përgatis formularin për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të personave të riatdhesuar, përmes institucioneve shëndetësore, duke i kushtuar vëmendje të posaçme personave me nevoja specifike (hemodializë, çrregullime të shëndetit mendor, personat me aftësi të kufizuara etj.)
- Të bëhet sa më parë, mundësisht në vend strehimet e përkohshme, identifikimi i personave të cilët kanë nevoja specifike.
- Të bëhet identifikimi paraprak i kapaciteteve të lira spitalore (veçanërisht për pacientët me nevoja specifike).
- Rezervimi i një numri të caktuar të kapaciteteve në spitale për personat e riatdhesuar.

3.3. Punësimi

Në fushën e punësimit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), apo më saktë Departamenti i Punës dhe Punësimit afron shërbime për personat që janë të papunë, të punësuar apo për ata që kërkojnë mundësitë për tu aftësuar. Strategjia e punësimit, planet dhe programet e MPMS-së mbulojnë politikat që kanë të bëjnë me punësimin dhe aftësimin profesional. MPMS afron këto shërbime:

- Regjistrimin,
- Mbështetje në gjetjen e punës,

- Informimin rreth tregut të punës,
- Këshillimin,
- Zhvillim të aftësive profesionale,
- Aplikimin për ndihmë sociale, etj.

Shkalla e papunësisë në Kosovë është shumë e lartë. Kështu që riatdhesimi do ta rëndojë situatën edhe më shumë. Megjithatë, kjo çështje duhet adresuar në politika, veçanërisht në Strategjinë e Punësimit të Kosovës, e cila është harmonizuar me Strategjinë Evropiane për mbështetje dhe punësim.

3.4. Politikat e punësimit

Politikat aktive të tregut të punës

MPMS-ja ka hartuar politikat dhe masat përmes të cilave do të ketë mundësi që të riatdhesuarve t'iu afrohen shërbime nëpërmjet shërbimeve të punësimit dhe të aftësimeve profesionale. Aktualisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale promovon gjashtë masa kryesore aktive të punësimit: këshillimi për punësim dhe orientimi në karrierë, informimin rreth tregut të punës, zhvillimi i aftësimit për treg të punës, krijimi i subvencioneve të punësimit, punët publike dhe programet e vetëpunësimit. Për momentin, kornizës ligjore bazike i mungojnë këto dhe masat pasive për tregun e punës si dhe procedurat për administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e këtyre masave. Projektligji i Punës është miratuar nga Qeveria dhe është proceduar në Kuvend dhe do të rregulloj në masë të madhe ambientin e punësimit. Megjithatë, janë duke u marrë masa kryesore aktive nga zyret e punësimit, programet për nxitjen e punësimit, dhe programeve tjera të veçanta. Këto programe duhet të fokusohen në personat e riatdhesuar të cilët e kanë gjendjen e rëndë ekonomike, që kanë, apo do të kenë vështirësi në tregun e punës.

Po ashtu, Qendrat për Aftësimeve Profesionale duhet të krijojnë kushte për aftësime nga profilet e ndryshme dhe për të ndihmuar në punësimin e tyre.

Politikat pasive të tregut të punës

Sistemi i tanishëm i mbrojtjes sociale përbëhet nga asistenca sociale dhe nga një rrjet qendrash për punë sociale. Këto qendra afrojnë shërbime këshillimi dhe referimi për individët dhe familjet e rrezikuara (kundërvajtësit e rinj, jetimët, viktimat e dhunës familjare, etj.)

Është krijuar një sistem pensional i përbërë prej tri shtyllash, përfshirë pensionin bazik me shumë fikse, një skemë të detyrueshme dhe skemën vullnetare me bazë në ndërmarrje. Sistemi pensional përplotësohet nga skema të veçanta për invalidët e luftës, pensionimi i parakohshëm për punëtorët e sektorit të xehetarisë dhe pensioni invalidor. Këto programe të mbrojtjes sociale mbështeten nga subvencione direkte dhe indirekte për grupet më të ndijshme.

Rekomandimet

- MPMS-ja të rritë shumën e buxhetit të alokuar dhe krijoj buxhet shumë-vjeçar për shërbimet sociale fillestare në mënyrë që të sigurohet planifikimi afatgjatë i shërbimeve të nënkontraktuara (outsourcing) të bazuar në nevojat e vlerësuara dhe në numrin specifik të personave të riatdhesuar si pjesë e marrëveshjes bilaterale për ri-pranim në mes të Kosovës dhe shteteve tjera;
- MPMS-ja të ketë parasysh caktimin e ekipit lëvizës përgjegjës për afrimin e

- shërbimeve sociale fillestare tek vendkalimi kufitar, sipas nevojës;
- MPMS-ja të ketë parasysh caktimin e ekipeve të veçanta përgjegjëse për afrimin e shërbimeve emergjente për personat e riatdhesuar, sipas nevojës;
 - MPMS-ja të krijoj procedura të shkruara specifike, transparente dhe të lehta për mbledhjen, ruajtjen, transferimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të personave të riatdhesuar;
 - MPMS-ja të krijoj procedura të shkruara specifike, transparente dhe të lehta për raportimin e rregullt në mes të ofruesve jo-qeveritar të shërbimeve dhe MPMS-së, dhe në mes të akterëve përkatës qeveritar në të dy nivelet, e cila mundëson vlerësimin, detektimin e shpejtë dhe reagimin ndaj nevojave të shkaktuara nga fluksi i supozuar rritës i personave të riatdhesuar;
 - MPMS-ja të krijoj procedura të shkruara specifike, transparente dhe të lehta mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve në përdorim në Kosovë në mënyrë që të sigurohet informimi efikas dhe me kohë i personave të riatdhesuar për të drejtat dhe përfitimet të cilat ju takojnë;
 - MPMS-ja të krijoj procedura të shkruara specifike, transparente dhe të lehta për informim dhe qarkullim të të dhënave dhe transfereve në mes të përfituesve të ndryshëm (jo-qeveritar dhe qeveritar, e po ashtu edhe institucionet publike ofruese të shërbimeve – kujdesi shëndetësor dhe arsimit), veçanërisht në nivelin vendor në mënyrë që të mënjanoen vonesat dhe të krijohen kushtet fillestare për riintegrim afatgjatë të personave të riatdhesuar;
 - MPMS-ja të rritë burimet financiare dhe njerëzore në mënyrë që të krijohet sistemi i qëndrueshëm i planifikimit dhe afrimit të përkohshëm të shërbimeve për strehim dhe shërbimeve tjera të lidhura me riatdhesimin e personave të cilët kanë nevojë (veçanërisht për kategoritë e ndjeshme, siç janë personat me aftësi të kufizuar, të moshuarit dhe fëmijët më nevojë), duke u bazuar në nevojat në rritje nga fluksi i supozuar ngritës i personave të riatdhesuar.

3.5. *Arsimi*

Në procesin e ri-integrimit të personave të riatdhesuar, procesi edukativo-arsimorë është i një rëndësie të posaçme. Me të kthyerit do të jetë edhe një numër i madh i fëmijëve dhe të rinjve të cilët duhet të vazhdojnë shkollimin. Hartimi i një udhëzimi administrativ me qëllim të përcaktimit të kushteve, kriterëve dhe procedurave në përmbushjen e kësaj strategjie nga ana e MASHT-it është më se i nevojshëm dhe do të qartësonte përgjegjësitë në mes të MASHT-së dhe Drejtorive Komunale të Arsimit.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), duhet të jetë e gatshme ti pranoj dhe sistemoj të gjithë nxënësit e të gjitha komuniteteve në të gjitha nivelet e arsimit shkollor dhe të mesëm, në mënyrë që të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm.

MASHT, në mënyrë të veçantë do t' i përkushtohet arsimin të detyrueshëm.

Fillimisht, nxënësit do të regjistrohen përmes procedurave joformale. Në këtë drejtim, MASHT-ja duhet urgjentisht të përpiloj broshurën për riintegrim në procesin arsimor për personat e riatdhesuar në lidhje me mundësitë për të gjitha shërbimet që janë në dispozicion, dispozitat ligjore dhe institucionet që janë përgjegjëse, në mënyrë që nxënësit ta kenë sa më lehtë regjistrimin në institucione shkollore. Pas regjistrimit,

fëmijët dhe prindërit do të obligohen të kompletojnë dokumentet e nevojshme, duke iu nënshtruar, procedurave për vërtetësi dhe nostrifikim.

Siç u cek më lartë, MASHT-ja do t'i sistemojë nxënësit dhe do të krijoj mundësi për shkollimin e tyre, sipas niveleve përkatëse. Për të përcjellë në mënyrë të përhershme gjendjen arsimore të të kthyerve, MASHT-ja autorizon fillimisht një zyrtar të saj për këtë çështje.

Sistemi arsimor i Kosovës përbëhet nga këto nivele: parafillor, fillor, i mesëm i ulët, i mesëm i lartë dhe arsimit i lartë.

Në nivelin e shkollimit parafillor (për fëmijët e moshës 5 vjeç), MASHT në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit do të krijoj mundësinë për shkollimin e fëmijëve.

Në rast të mungesës së hapësirës në objektet ekzistuese MASHT do të shqyrtojë mundësisë e ndërtimit të anekseve shtesë sipas nevojës.

Nxënësit në arsimin e obligueshëm, nuk do të sistemohen në klasa të veçanta, por në klasa të përziera me qëllim të ambientimit, familjarizimit dhe integritetit të tyre, në një të njëjtin mjedis me bashkëmoshatarët e tyre dhe natyrisht, kjo do të kontribuonte në ri-integrimin e suksesshëm dhe të lehtë të tyre. Nxënësve të riatdhesuar të shkollës fillore duhet t'iu sigurohen librat dhe materialet shkollore pa pagesë.

Nxënësit e shkollave të mesme të larta dhe shkolla profesionale do të regjistrohen dhe profilizohen në bazë të përmbajtjeve programore të realizuara në arsimin paraprak ose në drejtimet dhe profile të përafërta. Duhet të ketë një sistem për të krahasuar dhe vërtetuar certifikatat nga vendet mikpritëse.

Sa i përket arsimit të lartë, të gjithë personat e interesuar kanë mundësinë të përfshihen në universitetet publike apo në institucionet private të arsimit lartë në Kosovë.

MASHT-ja po ashtu afron mundësi për të gjithë ata të interesuar, të moshave të ndryshme, për të vazhduar mësimin jo formal. Këta të interesuar, në bazë të programeve mësimore të realizuara dhe moshës së tyre, mund të zgjedhin drejtimet e shkollave profesionale.

MASHT-ja, kujdes të veçantë do t'ju kushtojë nxënësve me nevoja të veçanta, të cilët do t'i përfshijë në shkollat speciale ose në shkollat standarde ku funksionojnë klasat e bashkangjitura. Sipas nevojës, MASHT-ja, do të shtoj numrin e këtyre paraleleve. Gjithashtu, MASHT-ja do të bashkëpunoj ngushtë me partnerët vendor dhe ndërkombëtar, që punojnë në sektor të ndryshëm të arsimit.

Komunat obligohen që të afrojnë shkollim special sipas ligjit dhe brenda mundësive të buxhetit ekzistues. Ato janë përgjegjëse për monitorimin e arsimit të nxënësve me nevoja të veçanta në sistemin e arsimit parauniversitar dhe në vlerësimin e nevojave.

Drejtorinë përkatëse në komuna duhet të zhvillojnë politika të reja për integrimin e personave të riatdhesuar me nevoja speciale në sistemin shkollor parauniversitar. Drejtoria komunale e arsimit duhet të miratojë politikat dhe planet dhe në bashkëpunim me drejtorët e shkollave, të përfshijë orë plotësuese dhe mësimin e aftësive speciale për personat e riatdhesuar që kanë lindur apo që janë rritur jashtë vendit.

Një numër i nxënësve kanë qëndruar dhe janë shkolluar për shumë vite në shtete të jashtme. Ata do të kenë vështirësi komunikimi dhe kuptimi në gjuhën amtare apo në gjuhën zyrtare të zgjedhur për shkollim. Për këtë kategori nxënësish, Drejtoritë Komunale për Arsim në komuna do të organizojnë kurse për mësimin e gjuhës. Kurset do të mbahen në shkollat ku nxënësit janë të regjistruar ose në qendra në të cilat do të tubohen nxënësit nga shkollat e afërta. Nxënësit, në bazë të një testimi paraprak do të kategorizohen në dy grupe: në nivelin bazë dhe të avancuar. Arsimtarët e angazhuar për kursin e gjuhës më parë do të vijojnë një trajnim nga ekspertët. Duhet të përcaktohet kohëzgjatja e kurseve dhe numri i orëve që duhet të mbahen. Drejtoritë Komunale për Arsim në Komunitet e Kosovës do të zhvillojnë politika dhe plane për përfshirje në shkolla edhe orë shtesë dhe mësimdhënie për personat e riatdhesuar që janë lindur apo rritur jashtë Kosovës.

Vëmendje e veçantë duhet kushtuar fëmijëve të komuniteteve të minoriteteve. Duhet të zhvillohen kurse të veçanta për tu mundësuar atyre të zënë hapin me fëmijët e tjerë të njëjtës moshë që janë në shkollat e rregullta. MASHT-ja duhet të monitoroj nga afër vijueshmërinë e tyre dhe duhet të organizoj programe për inkurajimin e tyre që të shkollohen.

Në Kosovë mësimi zhvillohet në katër gjuhë: shqipe, serbe, boshnjake dhe turke në të gjitha nivelet e shkollimit, me qëllim të gjithëpërfshirës dhe cilësisë së mësimin për të gjithë. Shkollimi i lartë në gjuhën boshnjake dhe atë turke është i kufizuar vetëm në fakultetin e edukimit.

Strategjia për riatësim dhe riintegrim do të zbatohet në të gjitha nivelet e arsimit për komunitetet pakicë, duke filluar nga niveli parashkollor, fillor, i mesëm dhe i lartë. MASHT -ja është e gatshme për të përkrahur, ndihmuar dhe afirmuar arsimin e komuniteteve duke krijuar kushtet për arsimimin e tyre. Serbët, boshnjakët, turqit, pjesëtarët e komunitetit RAE pa marrë parasysh dallimet gjuhësore, historike, në art, kulturë dhe traditë, janë kyçur mirë në mozaikun multietnik kosovar. Duhet të ketë mundësi të barabarta për arsimim cilësor në gjuhën amtare të të gjitha këtyre komuniteteve.

3.6. Infrastruktura shkollore

Për t'i pranuar dhe për të përcaktuar nivelin e të gjithë nxënësve të kthyer, MASHT-ja do të krijoj infrastrukturën e nevojshme:

1. Do të lejoj rritjen e numrit të nxënësve nëpër klasë,
2. Do të shfrytëzoj në mënyrë racionale hapësirën në objektet shkollore ekzistuese,
3. Do të pajisen hapësirat e reja dhe ato të rinovuara me kabinete të ndryshme dhe inventar të nevojshëm,
4. Do të sigurohet transporti i udhëtimit, veçanërisht në zonat rurale.

Rekomandimet

Për realizimin e planeve të lartpërmendur, MASHT-ja duhet të ndërmarrë këto aktivitete:

- MASHT-ja urgjentisht të përpiloj udhëzimin administrativ me qëllim të përcaktimit të kushteve, kriterëve dhe procedurave në përmbushjen e kësaj strategjie nga ana e MASHT-së. Po ashtu, të përcaktohen përgjegjësitë e MASHT-së në një anë dhe DKA-ve në anën tjetër më theks

të veçantë në planifikimin e buxhetit dhe alokimin e dedikuar për riintegrimin në arsim të personave të riatdhesuar;

- MASHT-ja të parasheh dhe siguroj mjete financiare për organizimin e kurseve gjuhësore, trajnimeve për arsimtarë, numër shtesë të arsimtarëve për nxënësit e riatdhesuar, një numër përkrahës të personelit nëpër shkolla, pajisje për shkolla dhe transportin për nxënës;
- MASHT-ja urgjentisht të përpiloj broshurën për riintegrim në procesin arsimor për personat e riatdhesuar në lidhje me mundësitë për të gjitha shërbimet që janë në dispozicion, dispozitat ligjore dhe institucionet që janë përgjegjëse;
- Komunat të krijojnë plane për përfshirjen e orëve shtesë dhe arsimtarëve në shkolla për personat e riatdhesuar të cilët kanë lindur dhe rritur jashtë shtetit;
- Komunat të përfshijnë komponentën riintegruese në kuadër të planifikimeve buxhetore dhe koordinojnë me komunitetin e donatorëve në nivelin lokal, me fokusim në riintegrim;
- MASHT-ja të krijoj grupin punues të përbërë nga Sekretari i Përhershëm i MSH-së dhe zyrtarët komunal me mandat për monitorimin e implementimit të strategjisë riintegruese për personat e riatdhesuar bazuar në komponentën arsimore;
- MASHT-ja duhet të krijojë klasë në gjuhët e pakicave në zonat ku janë të përqendruara këto pakica më së shumti dhe tu afrojë atyre libra shkollor, materiale dhe dokumente pedagogjike në gjuhët e tyre amtare.
- MASHT-ja duhet të monitorojë se sa e vijnë mësimin fëmijët e komuniteteve të minoriteteve dhe duhet të organizojë programe inkurajimi për arsimin e tyre.

3.7. Mirëqenia Sociale

Pas arritjes së personave të riatdhesuar në vendbanimin e tyre duhet informuar për të drejtat që ata kanë në skemat sociale ekzistuese në komunat e tyre përkatëse në Kosovë. Skemat iu dedikohen të gjithë qytetarëve në nevojë dhe nuk janë të lidhur me kontributet e mëhershme. Është me rëndësi të përmendet se skemat e mëhershme të sigurimeve sociale pensionalo-invalidore që nga viti 1999 nuk janë më në funksion dhe qytetarët nuk mund të përfitojnë nga këto skema. Për momentin ekzistojnë disa skema pensionale, përfshirë skemën e pensioneve bazike, skema pensionale për personat me aftësi të kufizuar, ndihma për familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme në bazë të Ligjit nr.03/L-022, skema për familjet e dëshmorëve dhe viktimave civile të luftës, për familjet e varfra dhe skema e pensionimit të parakohshëm për punëtorët e kompleksit Trepça.

Skema e pensioneve bazike

Në vitin 2002, Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjin për Pensionet Bazike. Ky ligj njeh të drejtën për pension të gjithë atyre personave që kanë moshën mbi 65 vjeç. Po ashtu, kërkohet që personat për t'u kualifikuar në këtë skemë duhet të dëshmojnë se janë banorë të përhershëm të Kosovës. Nuk ka rëndësi nëse personi realizon ndonjë formë tjetër të pensionit. Aktualisht pensioni ka vlerën 40 euro dhe administrohet nga MPMS-ja përmes administratës pensionale të Kosovës me zyra nëpër çdo komunë dhe rajon. Kjo skemë është pjesë e Strategjisë së MPMS-së edhe në të ardhmen.

Skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuar

Kjo skemë iu dedikohet të gjithë personave që janë të paaftë për punë përfshirë edhe pensionistët invalidor. Skema rregullohet me ligjin adekuat 2003/23 dhe Rregulloren për shpalljen e Ligjit 2003/40.

Shkallën e invaliditetit e përcakton Komisioni Mjekësor pranë Administratës Pensionale të Kosovës. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë banorët e Kosovës të cilët dëshmojnë se janë qytetarë të përhershëm të Republikës së Kosovës dhe se janë plotësisht dhe përherë të paaftë për punë. Kjo vlen për persona të rritur prej moshës 18 vjeçare deri në moshën 65 vjeçare. Ka edhe disa përfitime tjera që këta persona i gëzojnë, si: lehtësime për pagesa udhëtimi deri në 50%, në manifestime kulturo sportive, qasje fizike (pjerrina në të gjitha institucionet publike), lirohen nga pagesat doganore për mjetet që e ndihmojnë integrimin e tyre në jetë, etj. MPMS-ja, bashkë me MEF-in do të vazhdojnë të punojnë në rritjen e vlerës që paguhet me këtë skemë (aktualisht është 40 euro) në vazhdimësi konform rritjes së kostos së jetës.

Skema për familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme

Kjo skemë i dedikohet familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme nga 1-18 vjeç, skema realizohet në bazë të Ligjit nr. 03/L022.

Në bazë të ligjit nr.03/L022.

Ndihma dhe kujdesi për plotësimin e aktiviteteve të përditshme jetësore iu takon fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme të moshës 1-18 vjeçare, që janë qytetarë të Kosovës dhe janë me aftësi të kufizuar të përhershme që në mënyrë të pavarur të lëvizin dhe t'i kryejnë aktivitetet e përditshme jetësore, ku për këta persona është i nevojshëm kujdesi i huaj 24 orësh.

Fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme konsiderohen:

- a) fëmijët e palëvizshëm,
- b) fëmijët plotësisht të verbër si dhe,
- c) fëmijët të cilët për shkak të natyrës së sëmundjes apo sëmundjeve të përhershme, nuk janë të aftë që në mënyrë të pavarur të lëvizin vetë, në banesë, apo në vendet ku kanë nevojë, as në përdorimin e ndihmesave përkatëse, nuk janë në gjendje të ushqehen vetë, të zhvishen dhe të vishen, të kryejnë nevojat fiziologjike si dhe të mbajnë higjienën e domosdoshme, (Pagesa mujore për një fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershëm është 100 euro).

Skema për familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme

Kjo skemë realizohet në bazë të Ligjit nr. 03/L022, sipas të cilit, ndihma dhe kujdesi për plotësimin e aktiviteteve të përditshme jetësore iu takon fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme të moshës 1-18 vjeçare, që janë qytetarë të Republikës së Kosovës dhe që nuk janë në gjendje të lëvizin në mënyrë të pavarur dhe që kërkohet përkujdesja e huaj 24 orësh.

Fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme konsiderohen:

- a) fëmijët e palëvizshëm,
- b) fëmijët plotësisht të verbër si dhe,
- c) fëmijët të cilët për shkak të natyrës së sëmundjes apo sëmundjeve të përhershme, nuk janë të aftë që në mënyrë të pavarur të lëvizin vetë, në banesë, apo në vendet ku kanë nevojë, as në përdorimin e ndihmesave përkatëse, nuk janë në gjendje të ushqehen vetë,

të zhvishen dhe të vishen, të kryejnë nevojat fiziologjike si dhe të mbajnë higjienën e domosdoshme,

Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe viktimave civile të luftës

Përfitues të pensioneve nga kjo skemë janë të gjithë personat apo familjet që kanë pasur për pasojë lëndime-gjymtime ose humbjen e anëtarit të familjes në luftën e fundit në Kosovë gjatë vitit 1998/1999. Kjo skemë është e rregulluar me Ligjin për statusin dhe të drejtat e familjarëve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës. Kjo skemë administrohet nga MPMS-ja përmes Departamentit të familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës e cila e ka Zyrën qendrore në Prishtinë dhe Zyrat rajonale nëpër Kosovë.

Planifikohet që nga kjo skemë përfitojnë një numër i caktuar qytetarësh dhe atë përveç kompensimit material edhe shumë trajtime dhe beneficione tjera si mjete ndihmëse për të lehtësuar integrimin më të mirë për invalidët, trajtime të banjove klimatike falas, lehtësira në udhëtim, shkollim dhe shërbime shëndetësore.

Skema e ndihmës sociale (për familjet e varfra)

Kjo skemë rregullohet me Ligjin nr. 2003/15, me qëllim të mbrojtjes dhe përkujdesjes së familjeve të rrezikuara në aspektin social.

Skema e ndihmës sociale afron ndihmë financiare familjeve të përzgjedhura në përputhje me kriteret e parapara me këtë ligj dhe në bazë të mjeteve të ndara për këtë qëllim nga buxheti i Republikës së Kosovës. MPMS-ja i ka caktuar QPS-të për ta administruar skemën e ndihmës sociale. QPS-të ndodhen nëpër të gjitha komunat e Kosovës, gjithashtu janë themeluar edhe 14 zyra për të pasur qasje më të lehtë të komuniteteve që në atë komunë janë pakicë. Aplikuesit për këtë skemë përveç kushteve tjera, duhet të kenë letërnjoftimin e lëshuar nga autoritetet e Republikës së Kosovës për vete dhe për anëtarët tjerë të familjes më të vjetër se 16 vjeç, certifikatat e lindjes kërkojnë për anëtarët më të rinj se 16 vjeç.

Paraqitësi i kërkesës duhet të jetë qytetar i Kosovës e në rast se largohet nga Kosova asaj familje do t'i ndërpritet ndihma sociale.

Familje e kategorisë së parë sipas ligjit të skemës së ndihmës sociale është familja në të cilën të gjithë anëtarët e saj janë të varur sipas përkufizimit të këtij ligji dhe asnjëri prej këtyre nuk është i aftë për punë (në rast se prindi vetushqyes është i penguar të punoj).

Familje e kategorisë së dytë është familja me një anëtarë të aftë për punë dhe e cila ka:

- të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeç apo,
- që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën 15 vjeç.

Nga kjo skemë mund të përfitojnë, po ashtu edhe personat me të meta të rënda dhe aftësi përherë të kufizuara deri në 80%. Personat duhet të jenë të moshës mbi 16 vjeçare dhe nën moshën 65 vjeçare.

Paafhtësitë i përcakton komisioni mjekësor në çdo regjion i themeluar për këtë qëllim.

Skema e ndihmës sociale mendohet që të jetë e përhershme deri sa të ekzistoj nevoja për të dhe do të menaxhohet nga MPMS-ja përmes agjencive të caktuara.

Skema e pensioneve të parakohshme të punëtorëve të kompleksit Trepça

Përfituesit e këtij pensioni të parakohshëm janë të gjithë punëtorët e Trepçës dhe minierave me mihje nëntokësore të cilët i plotësojnë këto kritere:

- Të kenë moshën 50 deri në 65 vjeçare. Punëtorët e shpallur të paaftë për punë në minierë. Të këtë 10 apo më shumë vjet përvojë. Të jetë qytetarë të përhershëm të Republikës së Kosovës.

Kjo skemë nuk parashihet që të jetë e qëndrueshme sepse do të përfundoj me shkuarjen e kontingjentit të këtyre punëtorëve në skemën e pensioneve bazike.

Rekomandimet:

- MPMS duhet të mundësojë pa vonesë përfshirjen e personave të riatdhesuar në skemat e lartpërmendura.
- Personat e riatdhesuar që plotësojnë kriteret e përcaktuara për secilën skemë duhet të informohen me të drejtat e tyre dhe me procedurat e regjistrimit në ato skema.
- Qendrat për punë sociale duhet të marrin masa aktive për identifikimin familjeve që mund të kenë nevojë për ndihmë sociale.
- Autoritetet përgjegjëse duhet të shqyrtojnë mundësinë e rritjes së shumës së pensionit bazik për të plotësuar kushtet minimale të jetesës.

4. Grupet e pambrojtura

4.1. Viktimat e trafikimit

Shprehja „trafikim me njerëzit“ d.m.th. rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të mjeteve të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me format tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit apo keqpërdorimit të pushtetit apo pozitës për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit - (prostituimit, shfrytëzimit seksual, shërbimeve ose punës së detyruar skllavërisë, robërisë, ose heqjes së organeve).

Gjendja e rëndë ekonomike dhe financiare e të mbijetuarve nga trafikimi është një sfidë serioze për integrimin e suksesshëm social. Korniza strategjike dhe institucionale për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore tashmë është funksionale, mirëpo fokus i posaçëm duhet kushtuar trajtimit dhe integritet të mirëfillt të viktimave të trafikimit.

- Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2008-2011
- Strategjia si përgjegjësi e Qeverisë së Kosovës

E adresuar ndaj problemeve të trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë, kjo strategji ka karakter vendor, ku përgjegjësinë më të madhe në realizimin e synimeve strategjike, objektivave dhe aktiviteteve e ka marrë Qeveria e Kosovës, nëpërmjet institucioneve të saj. Pronësia Kosovare e kësaj strategjie, është realizuar gjatë procesit të hartimit të saj. Strategjia dhe plani i veprimit kundër trafikimit me qenie njerëzore është rezultat i bashkërendimit të përpjekjeve të qeverisë qendrore, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtar, zbatimi dhe monitorimi i saj do të kërkojnë të njëjtin bashkëpunim.

- Mbështetur në burimet e brendshme

Pronësia Kosovare e Strategjisë, përforcohet nga fatura financiare e saj ndaj buxhetit të shtetit. Efekti financiar i strategjisë do të mbulohet kryesisht nga buxheti i shtetit, e lidhur dhe e harmonizuar me strategjitë sektoriale si ajo e arsimit, shërbimeve sociale, shëndetësisë, punësimit etj.

- Strategjia si produkt i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtar

Reformat dhe politikat e zhvillimit, ashtu sikurse përballimi i situatave të vështira politike që ka kaluar vendi, janë mbështetur gjerësisht nga partnerët tanë

ndërkombëtarë. Qeveria e Kosovës, është e ndërgjegjshme se zbatimi i strategjisë do të kërkojë para së gjithash mobilizimin e burimeve të brendshme njerëzore e materiale, por realizimi i politikave të parashikuara në kuadrin e strategjisë do të kërkonte edhe mbështetjen e partnerëve ndërkombëtar, dhe institucioneve të specializuara ndërkombëtare. Për këtë arsye, Qeveria e Kosovës angazhohet për një përdorim efektiv të kësaj mbështetjeje.

Gjithashtu, mbështetja në institucionet e Kosovës dhe kapacitetet njerëzore të tyre për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të parapara në planin e veprimit, ka siguruar "Pronësinë e Qeverisë së Kosovës" mbi strategjinë.

Plani i Veprimit 2008-2011, është realizuar përmes një sistemi të gjerë pjesëmarrjeje, që përfshinë institucionet qendrore, shoqërinë civile (organizatat jo-qeveritare vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë), dhe partnerët ndërkombëtar. Pjesëmarrja e gjerë e grupeve të interesuara, përbën edhe një tipar dallues të kësaj strategjie. Ajo përbën një nga garancitë e suksesit të saj.

Struktura institucionale e hartimit të strategjisë përbëhet nga i) Koordinatori shtetëror kundër trafikimit me qenie njerëzore, njëkohësisht përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Brendshme; Grupet e punës (parandalimi, mbrojtja dhe persekutimi); grupi teknik mbështetës (WSSA-UNDP).

Koordinatori shtetëror kundër trafikimit me qenie njerëzore, njëkohësisht zv. Ministri i Punëve të Brendshme, koordinon dhe organizon punën për hartimin dhe zbatimin e kësaj strategjie.

Grupet e punës, janë përgjegjëse për elaborimin e problemeve sektoriale të strategjisë, dhe furnizimin me informacionin përkatës. Grupet e punës janë përzgjedhur në mënyrë të tillë që të përfaqësojnë gjerësisht institucionet publike dhe shoqërinë civile.

Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut

Kjo strategji, ka një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut, dhe është e lidhur me promovimin dhe mbrojtjen e tyre, në veçanti në mbrojtjen e të drejtave të viktimave të trafikimit kur ato janë fëmijë dhe gra. Gjatë hartimit të këtij dokumenti, pjesëmarrësit kanë qenë të vetëdijesuar mbi të drejtat të cilat tentohen të shkelen gjatë trafikimit me qenie njerëzore, siç janë :

- E drejta për liri dhe sigurinë e personit,
- E drejta për të mos u mbajtur në skllavëri,
- E drejta për t'u trajtuar me humanizëm dhe respekt,
- E drejta e lëvizjes dhe liria për të zgjedhur vendbanimin,
- E drejta për të mos u torturuar dhe e drejta për të jetuar, e drejta në shëndet.

Për këtë arsye, qasja ndaj viktimës fokusohet në mbrojtjen e të drejtave të saj, në aspektin e sigurimit të informacionit të nevojshëm, mbrojtjes fizike dhe ligjore, asistencës dhe kompensimit material për të mundur integrimin afatgjatë të saj.

Një qasje e veçantë e këtij dokumenti, është dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve. Situata specifike e fëmijëve është marrë në konsideratë në të gjitha veprimet e parapara në Planin e Veprimit. Parandalimi i trafikimit të fëmijëve, dhe mbrojtja e veçantë e tyre nga viktimizimi, është konsideruar si një nga sfidat kryesore të kësaj strategjie.

4.2. Mekanizmat institucional ekzistues

Ekzistojnë disa institucione përgjegjëse në nivel të hartimit dhe zbatimit të politikave shtetërore kundër trafikimit me qenie njerëzore. **Ministria e Punëve të Brendshme**, e

cila nëpërmjet Sektorit Kundër Trafikimit me Qeniet Njerëzore (SKTQNJ), punon në parandalimin e krimit dhe veprave të trafikimit, mbrojtjen viktimave të trafikimit dhe ndjekjen e kryerësve të krimit dhe prezantimin e fakteve në gjykatë. **Ministria e Drejtësisë**, e cila nëpërmjet Divizionit për Avokim dhe Ndihmë Viktimave (DANV), afron ndihmë juridike dhe strehim për viktimat e trafikimit. **Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale**, e cila nëpërmjet qendrave për punë sociale dhe strehimoreve afron politika dhe shërbime për integrimin e viktimave në jetën normale.

Koordinatori Shtetëror Antitrafikim (KSHA), i njehsuar me Zëvendës Ministrin e Brendshëm, është një strukturë e re e sapokrijuar. Mandati i të cilit është koordinimi dhe bashkërendimi i aksioneve politike kundër trafikimit me qenie njerëzore.

Rekomandimet:

- MPMS-ja së bashku me Institutin për Politika Sociale duhet të kryejnë hulumtim gjithëpërfshirës për të ekzaminuar efektivitetin e programeve ekzistuese të përfshirjes sociale për viktimat e trafikimit.
- MPMS-ja, me mbështetjen të komunitetit donator, zhvillon një plan dhe strategji për rehabilitimin e fëmijëve të mbijetuar nga trafikimi me qenie njerëzore, kthimi i të cilëve në familje nuk është i mundur. Kjo mund të përfshijë programet e birësimit, mundësitë e banimit, edukimi dhe rehabilitimi i fëmijëve që kanë mbijetuar trafikimin.³
- Koordinatori Kosovar Kundër-Trafikimit dhe Grupi Punues Ndërmënyor duhet të hartojnë një strategji të përcaktuar për të pranuar fonde për programe të përfshirjes sociale. Strategjia duhet të përfshijë dhe t'ju jap prioritet Fondit të themeluar për Kompensimin ndaj Viktimave siç është paraparë me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale për të përfshirë fondet për përkrahje ekonomike dhe financiare për të mbijetuarit nga trafikimi, të cilët janë trafikuar në Kosovë. MAPL-ja duhet të udhëheq dhe mbikëqyr implementimin e kësaj strategjie në nivelin lokal.
- Kjo strategji duhet të përfshijë mbrojtjen, mbështetjen për viktimat, mbrojtjen sociale dhe masat standarde për identifikimin e viktimave. Duhet të zhvillohet bashkëpunimi në mes të akterëve për t'u afruar viktimave ndihmë në fushën e mjekësisë, arsimit, strehimit, si dhe ndihmën psikologjike dhe financiare, etj.

4.3. Nënata vetë-ushqyese

Shkalla e papunësisë në Kosovë është e lartë, në veçanti për nënat vetë-ushqyese, ku dhe ato vazhdojnë të bien në kategorinë e grupeve të dobëta pasi që kanë mundësi të vogla të punësimit, me qëllim të sigurimit të kushteve më të mira për fëmijët e tyre.

Rekomandimet

- MPMS-ja duhet të siguroj mundësi punësimi për nënat vetë-ushqyese përmes Zyrës së Punësimit të MPMS-së.
- Departamenti për Mirëqenie Sociale - Divizioni për Asistencë Sociale - duhet vlerësoj kriteret për pranim në skemën për asistencë sociale dhe për të siguruar

³ Për një listë emergjente të hollësishme dhe garanci të tjera intervenime afat-gjata, gjithashtu shohin PVPT 'Raporti mbi Rekomandimet për aksionet e policisë për tërheqje dhe rehabilitim afat-gjatë të fëmijëve viktimat të formave më të këqija të punës së fëmijëve.' Ekzistojnë praktika të mira dhe mësimet në këtë raport në ri-integrimin social-ekonomike të fëmijëve duke përfshirë të mbijetuarit e trafikimit që MPMS mund ta gjejnë si të dobishme.

mbrojtje më të mirë të femrave vetë-ushqyese, pasi që ato bëjnë pjesë në kategorinë e grupeve vulnerabël.

- Agjencia për Barazi Gjinore brenda Qeverisë së Kosovës duhet të marrë pjesë në grupin punues të ekspertëve për të hartuar strategjinë si dhe inkorporimin e femrave vetë-ushqyese dhe pozitën e femrave në fuqinë e punës në projektet e zhvillimit.

4.4. Fëmijët pa përkujdesje familjare dhe fëmijët e braktisur

Mbrojtja e këtyre fëmijëve realizohet përmes aktiviteteve të shtuara për bashkim familjar, birësim apo strehim në familje tjetër. Strehimi familjar paguhet nga MPMS-ja në baza mujore për shpenzimet për fëmijët në ato strehimore.

Fëmijët e riatdhesuar pa përkujdesje familjare, ndonëse raste të tilla janë të rralla, menjëherë do të përfshihen në programet ekzistuese për mbrojtjen e këtyre fëmijëve. MPMS-ja duhet t'u kushtoj kujdes të veçantë këtyre fëmijëve nëse do të ketë raste të tilla në të ardhmen.

4.5. Fëmijët pa kujdes prindëror si dhe fëmijët e abuzuar dhe keqtrajtuar

Për fëmijët pa kujdes prindëror si dhe për fëmijët e abuzuar dhe keqtrajtuar, institucionet e Republikës së Kosovës janë të detyruar të afrojnë shërbime sociale në Kosovë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

MPMS-ja ka kontraktuar blerjen e shërbimeve për të vendosur këta fëmijë nga një OJQ me kapacitet vjetor deri në 50 fëmijë. Fëmijët qëndrojnë këtu në afat sa më të shkurtër që është e mundur dhe kthehen në familje sapo të jenë krijuar kushte të volitshme ose dërgohen në familje tjetër në strehim familjar.

4.6. Mbrojtja e fëmijëve me nevojat të veçanta

Duke njohur nevojat e veçanta të fëmijëve me aftësi të kufizuara, synohet që fëmijët të kenë mundësi të marrin arsim, shërbime shëndetësore, përgatitje për punësim dhe veprimtari argëtuese në mënyrë që ai të ketë integrim shoqëror dhe zhvillim më të plotë.

Rekomandimet:

- MPMS-ja duhet t'i kushtoj vëmendje të posaçme fëmijëve pa përkujdesje familjare të cilët riatdhesohen nga vendet tjera, nëse ka raste të tilla.
- Fëmijëve të riatdhesuar duhet t'ju afrohet mbështetje psikologjike për tu përshtatur në mjedisin e ri si dhe ndihmë në fushën e shëndetësisë, arsimin, strehimin dhe në fusha tjera.

4.7. Personat e moshuar pa përkujdesje familjare

Në Kosovë ekziston trajtim institucional për personat e moshuar e pa përkujdesje familjare. MPMS-ja bënë pranimin dhe mbulon shpenzimet për secilin person në këto institucione. Personat e riatdhesuar të kësaj kategorie duhet të pranohen në këto shtëpi me kushte dhe drejta të barabarta si personat tjerë.

Rekomandimet:

- MPMS-ja duhet të pranoj pa vonesë të riatdhesuarit e moshuar pa përkujdesje familjare.
- Procedurat për pranimin e personave në këto shtëpi duhet jenë të njëjta sikurse të personave tjerë që i përkasin kësaj kategorie.

4.8. Personat me aftësi të kufizuara mendore dhe pa përkujdesje familjare

MPMS-ja tanimë e ka të aprovuar politikën e de-institucionalizuar që ka për qëllim të bëjë kategorizimin e rasteve dhe të merret me rastet me retardime të rënda mentale të

karakterit social. Instituti special i Shtimes është institucion publik me karakter social në kuadër të MPMS-së i cili është kompetent për tu marrë me këto raste.

Rekomandimet:

- Qeveria e Kosovës duhet të negocioj me vendet nikoqire për moskthimin e personave me të meta mentale. Duhet përfshirë një dispozitë e veçantë në lidhje me këtë në të gjitha marrëveshjet/aranzhimet e ripranimit.
- Kapacitetet dhe institucionet që përkujdesen për personat me të meta mentale duhet të përmirësohen dhe zgjerohen.

5. Banimi dhe çështjet pronësore

Banimi është e drejtë e qytetarëve, pasi që është vendimtar për shëndetin dhe zhvillimin e njerëzve. Ai është vendi ku dëshirojnë të investojnë dhe kështu të përmirësojnë mundësitë e tyre për komunikim.

E drejta në banim gjithnjë e më shumë është e pranishme në kuadër të politikave globale dhe në luftë për të drejtat njerëzore, në përputhshmëri me trajtimet ndërkombëtare.

Spektori i banimit është segment i gjerë dhe kompleks, i cili ndërlidhet edhe me sektorë të tjerë të shoqërisë. Në shumicën e vendeve, çështja e banimit për shkak të rëndësisë së vet, në shumicën e vendeve nuk i është lënë stuhisë së tregut. Përkundrazi, ekzistojnë mekanizma dhe intervenime të ndryshme të shtetit që janë themeluar për të zhvilluar këtë sektor.

Gjatë luftës, fondi i banimit në Kosovë është dëmtuar plotësisht ose pjesërisht për 27% e shumës së përgjithshme të fondit të banimit, gjegjësisht rreth 120.000 mijë shtëpi. Deri në fund të vitit 2002 janë rindërtuar rreth 60.000 shtëpi nga ana e donatorëve ndërkombëtar, dhe një numër konsiderueshëm është rindërtuar me vetëfinancim.

Në Kosovë, ekzistojnë së disa Qendra të Përkohshme Kolektive (QPK) ku qëndrojnë një numër i konsiderueshëm i familjeve, sidoqoftë, kushtet e banimit në këto qendra nuk i plotësojnë standardet minimale për banim dhe karakterizohen me mungesë të hapësirës, mungesë të mirëmbajtjes së objekteve dhe si rezultat objektet janë të dëmtuara. Përveç kësaj, edhe kushtet higjienike janë të ulëta dhe ka mungesë të madhe të ujit dhe ngrohjes. Familjet në këto qendra jetojnë kryesisht me asistencë sociale, shumica nuk posedojnë pronë - pasuri të paluajtshme, ndërsa me forcat e veta financiare-materiale nuk mund të zgjidhin çështjen e banimit madje as me dekada.

Pas luftës, sektori i banimit në Kosovë është karakterizuar kryesisht nga zhvillimi në sektorin privat (shtëpi individuale dhe objekte banesore) dhe pjesërisht edhe nga sektori publik (objekte banesore dhe rindërtimi i shtëpive) financuar nga qeveria, komunat dhe donatorët. Ndërtimi i objekteve banesore me karakter social nga komunat, qeveria dhe donatorët, iu dedikohen familjeve të pastreha të cilat jetojnë në Qendrat e Përkohshme Kolektive(QPK), ndërsa përparësi në sigurimin e strehimit kanë kryesisht femrat kryefamiljare, fëmijët bonjakë dhe grupet tjera në gjendje të vështirë, etj.

Ky proces është implementuar sipas programit dhe udhëzuesit për banim social të hartuar në vitin 2003 nga DBN. Në programin dhe udhëzuesin për banim social janë definuar burimet e financimit, procedura për selektimin e familjeve, standardet e banimit dhe të drejtat dhe obligimet e përfituesve të banesës të përcaktuara me kontratën për banim me qira.

Me aprovimin e Ligjit për " Financimin e programeve të veçanta të banimit" janë krijuar parakushtet për afrimin e zgjidhjeve të reja për familjet që ekonomikisht nuk kanë mundësi të gjejnë zgjidhje për çështjen e banimit pa ndihmën e shtetit. Ky ligj parasheh zgjidhjen e qëndrueshme të çështjes së banimit nëpërmjet banimit me qira joprofitabile, ku përfshihen banesat e ndërtuara nga komuna, qeveria dhe donatorët.

5.1. Korniza institucionale

5.2. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Në kudër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ekziston Departamenti i Banimit dhe Ndërtimit misioni i të cilit është krijimi i kornizës së nevojshme ligjore, institucionale dhe financiare që do të mundësojnë qasje të barabartë për të gjithë qytetarët për banim të përshtatshëm, duke u bazuar në mundësitë e tyre financiare dhe në statusin e tyre social dhe shëndetësor.

- Komunat, në bazë të Ligjit për programet e veçanta të banimit, komunat hartojnë programet tre vjeçare për banim varësisht prej kërkesave për banim në territorin që kanë nën juridiksionin e tyre.
- AKP- aktualisht administrojnë me 5,000 prona banesore.

5.3. Autoritetet Komunale

Në komuna nuk ekzistojnë sektor të veçantë për banim. Funksionet e nivelit qendror dhe lokal për sektorin e banimit nuk janë të rregulluara me kornizë ligjore.

Problemet financiare dhe buxheti

Fondet buxhetore të Qeverisë janë të kufizuara dhe e bëjnë të pamundur sigurimin e banimit për grupet e njerëzve që nuk mund ta përballojnë vetë.

Implementimi i Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit, varet nga sigurimi i buxhetit nga niveli qendror, niveli lokal dhe donatorët.

Përveç kësaj, nuk ekziston asnjë burim tjetër i kredive afat-gjata për sigurimin e banimit shoqëror.

Bankat private nuk janë të përfshira në investimet e banimit për shkak të mungesës së garancive të besueshme ose janë të përfshira me përqindje të lartë interesi me kredi të vogla për mirëmbajtje ose renovim të banesave (Sistemi kreditor i kufizuar dhe me kamata të larta 11-12%).

5.4. Qiraja dhe politikat e qirasë në fushën e banimit

Segment me rëndësi për politikat e banimit është qiraja dhe raportet qiramarrëse. Përcaktimi i politikave të qirasë me ligj është me rëndësi të veçantë për sigurimin dhe subvencionimin e qirasë për grupe dhe kategori sociale të qytetarëve. Politikat e qirasë në banim në çdo shtet janë të trajtuara dhe rregulluara. Përmes tyre rregullohen dhe mbrohen të drejtat dhe detyrimet e raporteve qiramarrëse për llojin e banimit me qira të lirë/tregut, qirasë jo-profitabile dhe subvencionuese.

Definimi i qirasë jo-profitabile dhe atyre subvencionuese ka rëndësi të veçantë në përcaktimin e kriterëve për përfitimin e të drejtës për vendosje, kohëzgjatjen për shfrytëzimin e banesës, llogaritjen dhe pagesën e qirasë jo-profitabile, kontrollin e

lartësisë së qirasë etj. Në situatën e tanishme, autoritetet qendrore dhe lokale kanë numër të kufizuar ose nuk kanë fond të banesave për dhënie me qira jo-profitabile dhe subvencionuese.

Ligji për “financimin e programeve të veçanta të banimit” mundëson sigurimin e banimit përmes programeve të veçanta të financimit për banesa me qira ku përfshihen banesat e ndërtuara nga komuna, qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira, banesat ekzistuese në pronësi të personave fizik apo juridik, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit dhe banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për banim.

Organet kompetente komunale, me vendim të Kuvendit Komunal, mund të lejojnë bonuse të banimit për shfrytëzimin e banesave me qira nga banesat në treg, kur: ndërtimi i banesave është më i kushtueshëm dhe kur mungojnë fonde për investime të reja. Bonusi i banimit aprovohet në Kuvendin Komunal, varësisht nga mundësitë buxhetore.

Kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet për banim caktohen me vendim të Kuvendit Komunal përkatës dhe përfshijnë familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale, kanë mbetur pa banesë-shtëpi, si rezultat i dëmtimit të shtëpive gjatë luftës së fundit në Kosovë posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike Administrimi i kërkesave për programet e banimit dhe caktimi i përparësive bëhen nga organi kompetent komunal.

Përfitimi nga programet e banimit bazohet në verifikimin e gjendjes ekonomike të familjes. Verifikimi i gjendjes ekonomike të familjes bëhet nga organi kompetent komunal.

Fillimi i zbatimit të këtij ligji mund të bëhet në pilot-komuna që kanë numër të madh të kërkesave për banim me përkrahje për ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe njerëzore.

5.5. Bashkëpunimi i MMPH-së me ministrinë e linjës

- Bashkëpunimi në mes të MPB-së, MMPH-së, MPMS-së dhe AKP-së, bëhet me këmbimin e informacioneve për personat të cilët duhet të riatdhesohen.
- Posaçërisht, këmbimi i informatave paraprake me MPB-në, duhet bërë në mënyrë të organizuar. MPB-ja duhet dizajnuar një formular me të gjitha informatat e rëndësishme për ministrinë përkatëse, t'i mbledh ato nga shtetet kërkuese dhe t'i shpërndaj ato informata ministrive përkatëse.
- Siç u përmend më herët në strategji, MPB-ja është përgjegjëse për të informuar MPMS-në për rastet e pranuar të riatdhesimit dhe të shpërndajë informacionet për nevojat e tyre pas kthimit. Pastaj edhe MMPH-ja dhe AKP-ja duhet të informohen për rastet e pranuar për riatdhesimin e personave që nuk kanë strehim në Kosovë. Kjo do t'ju mundësoj atyre të bëjnë përgatitjet e nevojshme për akomodimin e atyre personave pasi të arrijnë. MMPH-ja, në bazë të informatave për nevojat e banimit për personat e riatdhesuar, të konfirmuara nga komunat, harton projekt propozimet buxhetore për vitin vijues sipas kritereve të programit dhe udhëzuesit për banim social.
- Komuna nga e cila e ka origjinën personi që duhet të riatdhesohet duhet të marrë obligimet mbi identifikimin e ndonjë pasurie të paluajtshme të personit në fjalë. Këtu

nuk duhet të vërtetohet vetëm se a ka objekt banimi, por gjithashtu edhe a ka tokë, në mënyrë që ai person të mos identifikohet si person pa asnjë pasuri të paluajtshme.

- Komuna gjithnjë në bashkëpunim me MPB-në, duhet të kujdeset që gjatë verifikimit për pronës së paluajtshme në emër të personit që duhet të riatdhesohet, duhet të kenë parasysh që të bëjnë verifikimet e nevojshme edhe për pronën në emër të anëtarëve të familjes së ngushtë siç janë: prindërit dhe vëllezërit, sepse mund të ndodhë që personi i cili duhet të riatdhesohet nuk ka asnjë pronë në emër të vet, sepse prona është në emër të prindit ashtu siç është traditë jo vetëm në Kosovë por edhe në Ballkan.

5.6. Agjencia Kosovare e Pronës

Bashkëpunimi i ngushtë i komunave dhe AKP-së për personat të cilët kanë paraqitur kërkesat për kthimin e pronës dhe që përfshihen në listë për kthim në Kosovë, është me se i domosdoshëm, pasi AKP disponon me bazën e të dhënave me kërkesat të cilat janë paraqitur në AKP. Kjo do të mundësojë identifikimin e të gjithë atyre që janë në listë për riatdhesim. Në këtë mënyrë, AKP do të përshpejtojë procedurat, në mënyrë që banuesi aktual të largohet nga prona në mënyrë që pronari të ketë objektin banesor në dispozicion, në momentin kur të hyjë në Kosovë. Të gjitha obligimet për shpejtimin e procedurave lidhur me kërkesat e tyre në AKP do të ndërmerr AKP.

Një qasje e tillë do të evitonte problemet për qendrat transitore.

Për personat të cilët ende nuk ndihen të sigurt për kthimin në vendin e origjinës, MPB-ja duhet të bëjë përpjekje që të kërkojë nga vendet kërkuese që kthimi të bëhet i organizuar dhe të ketë parasysh shtrirjen gjeografike të këtyre personave.

Janë tri zgjidhje të qëndrueshme që sugjerohen për zgjidhjen e çështjes së banimit për të riatdhesuarit:

- programet e banimit në bazë të Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit (MMPH, Komunitat).
- Rindërtimi i shtëpive individuale në tokën e cila është në pronësi të personit të riatdhesuar në bazë të Udhëzuesit për Rindërtim (MKK).
- Futja e këtyre personave në skemën e qirasë në pronat të cilat administrohen nga AKP.

Rekomandimet:

- Të krijohet fondi qeveritar për akomodimin e personave të riatdhesuar në kuadër të fondit për riintegrim.
- MMPH-ja në bashkëpunim me AKP, Komunitat dhe Agjencioni Kadastral duhet gjetur mundësinë më të mirë për të sistemuar personat e riatdhesuar.
- Duhet krijuar skemën e qiradhënies për personat e riatdhesuar që kanë nevojë për banim dhe kjo skemë duhet t'ju afrohet edhe familjeve me të hyra të ulëta dhe atyre me subvencion.
- MMPH-ja në konsultim me ministrinë tjera të përfshira duhet të gjejnë zgjidhje të qëndrueshme prej këtyre tri opsioneve të sugjeruara.
- Duhet të aprovohet korniza e re ligjore që ka të bëjë planifikimin, administrimin dhe zbatimin e programeve për banim social dhe për krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm të bazuar në kapacitetet financiare të familjeve.

- Duhet të zhvillohet bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për të reaguar ndaj kërkesave për strehimin me kohë të personave të riatdhesuar.
- Duhet të fuqizohet zbatimi i Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit, i cili ka për qëllim krijimin e kushteve për banim të qëndrueshëm për familjet ose individët nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të lirë.
- Institucionet përkatëse duhet mirëmbajtur/rinovuar ku ka nevojë QPK-të. Kushtet e jetesës duhet përmirësuar nëpër QPK për të arritur këtë duhet pasur mjete financiare të cilat institucionet relevante duhet siguruar ose përmes buxhetit të tyre apo përmes fondit qeveritar i cili rekomandohet të krijohet sa më shpejtë.

6. Partneriteti dhe evidentimi i përgjegjësive në vijën horizontale dhe vertikale

Institucionet qendrore do të jenë përgjegjëse për shqyrtimin e marrëveshjeve aktuale të ri-pranimit dhe praktikave të kthimit nga shtetet kërkuese, të shqyrtojë praktikën dhe politikën mbi mekanizmat e kthimit dhe re-integrimit dhe veçanërisht të vlerësojë zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese të ri-pranimit nga autoritetet përkatëse dhe të monitoroj procesin. Pushteti qendror duhet të zhvillojë politika dhe programe të përbashkëta për të gjitha institucionet qendrore dhe lokale, dhe duhet ta mbikëqyrë zbatimin dhe suksesshmërinë e programeve për re-integrim. Këto do të integrohen përmes një plani operacional të veprimit.

Në nivelin qendror, ministrinë kryesore të cilat duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e re-integrimit janë:

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB);
 Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (MPMS);
 Ministria e Shëndetësisë (MSH);
 Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal (MAPL);
 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH);
 Ministria e Kthimit dhe e Komuniteteve (MKK);

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT);
 Ministria e Drejtësisë (MD);
 Agjencia Kosovare e Pronës (AKP).

6.1. Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe ndalimi i praktikave diskriminuese

Në procesin e ri-integrimit të personave të riatdhesuar do të respektohen standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Kjo nënkupton që në procesin e re-integrimit të personave të riatdhesuar nuk do të lejohet të ketë kurrfarë praktikash diskriminuese në çfarëdo baze të jenë ato, etnike, racore apo fetare.

Qëllim i punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës është përmirësimi i jetës së qytetarëve dhe synon që këtë ta realizojë përmes ndalimit të sjelljeve diskriminuese, duke i sanksionuar veprimet e paligjshme.

Objektivat, koordinimi dhe prioritetet

6.2. Roli koordinues në raport me komunat:

Për ta zbatuar strategjinë dhe planin e veprimit (pas miratimit të strategjisë) për riintegrimin e personave të riatdhesuar duhet krijuar një fond i cili do të mundëson financimin e aktiviteteve të nevojshme. Ky buxhet duhet planifikuar dhe duhet parashikuar kategori të posaçme ose të planifikuar të buxhetit për re-integrimin e personave të riatdhesuar. Procesi i re-integrimit është proces i ndërlikuar, por komunat nuk kanë nevojë që të krijojnë struktura të reja jashtë kuvendeve komunale për trajtimin e këtyre çështjeve. Lidhur me rolin koordinues në mes të institucioneve lokale dhe qendrore, duhet ta ketë Kryetari i Komunës respektivisht Drejtori i Administratës. MAPL-ja do të bashkërendojë aktivitetet në mes MPMS-së dhe MMPH-së dhe komunës, lidhur me menaxhimin e qendrave për akomodim të përkohshëm afatshkurtër dhe qendrave për banim social.

Shërbimet: Të gjitha departamentet komunale merren me një ose më shumë fusha në të cilat komunat afrojnë shërbime. Për shembull, Departamenti i Shëndetësisë merret me shërbimet urgjente dhe ato shëndetësore pasi që aktualisht komunat afrojnë shërbime urgjente dhe të shëndetit primar. Departamenti për Strehim dhe Qendra për Punë Sociale dhe Mirëqenie Sociale, të cilat janë do të barten në nivelin lokal, duhet të përfshihen në sigurimin e akomodimit për të gjithë të riatdhesuarit të cilët kanë nevojë. Departamenti i Arsimit merret me arsimin deri në nivelin universitar dhe punon për çdo ditë me të gjitha shkollat. Drejtoritë e tjera gjithashtu, do të jenë të përfshira në afrimin e shërbimeve në pajtim me fushën të cilën e mbulojnë.

Komunat nuk do të jenë në gjendje ta luajnë rolin e tyre pa pasur burime proporcionale për detyrat e tyre. Në bazë të përvojës është dëshmuar që asnjë ZKK ose ZKB nuk kanë mundur t'i kryejnë detyrat e tyre me buxhet të vogël. Burimet financiare janë çështja kryesore në këtë proces të ndjeshëm dhe afatgjatë. Për secilën zyrë komunale/lokale duhet të sigurohen pajisje të përshtatshme për kryerjen e punës së tillë në terren.

6.3. Konkluzione dhe rekomandime në kuadër të bashkërendimit të aktiviteteve në mes të pushtetit qendror dhe atij lokal

Disa ministri në kuadër të Qeverisë së Kosovës (MAPL dhe MPB), do të kenë rolin koordinatues dhe bashkërendues në mes institucioneve në vijë horizontale dhe vertikale. Kështu që ato do të jenë përgjegjëse për sa vijon:

- Të sigurojnë zbatimin e strategjive dhe programeve të qeverisë për re-integrimin e personave të riatdhesuar;
- Mbështesin pushtetet lokale të bëjnë identifikimin e donatorëve të mundshëm, duke i këmbyer praktikant më të mira për procesin e re-integrimit të vendeve të rajonit dhe praktikave të BE-së;
- Zhvillojnë projekte të përbashkëta me komunat, nga të cilat do të mund të përfitonin të riatdhesuarit;
- Bëjnë bashkërendimin e aktiviteteve në mes institucioneve të pushtetit lokal dhe qendror, dhe donatorëve, duke përkufizuar programet e ardhshme të ndihmës në procesin e re-integrimit;

- Mbikëqyrin progresin lidhur me zbatimin e strategjisë për re-integrim nga ana e komunave dhe bën raporte periodike për Qeverinë me qëllim të informimit lidhur me implementimin e procesit të riintegritimit në nivel komunal.
- Rekomandon zgjidhje të qëndrueshme dhe adopton praktikat e mira lidhur me re-integrimin për zbatimin e strategjisë nga komunat.

7. Mekanizmat Koordinues për Implementimin e Strategjisë për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar

7.1. Bordi Koordinues Ndërministror

Bordi koordinues ndërministror është formuar që të siguroj implementimin efikas të strategjisë dhe planit të veprimit për re-integrimin e personave të riadhesuar. Bordi do të përbëhet prej ministrive si në vijim: MAPL, MPB, MPMS, MMPH, MASHT, MSH, MKK dhe MFE. Organizatat ndërkombëtare si dhe akterët e tjerë relevant të shoqërisë civile do të kenë një rol këshillues dhe do të jenë pjesëmarrës aktiv në këtë proces.

7.2. Bordi koordinues ndërministror në bashkëpunim me sekretariatit e tij do të:

1. Përgatis planin e veprimit për implementim të strategjisë;
2. Dizajnon dhe propozon buxhetin për implementim të strategjisë;
3. Do të menaxhoj me fondin për riintegrimin e personave të riadhesuar, do të merr vendime si të shpenzohet ky fond dhe do të bëjë monitorimin e shfrytëzimit të këtij fondi.
4. Cakton zonat e përgjegjësisë për çdo ministri relevante, në nivelin qendror dhe në nivelin komunal për administratat e drejtorive dhe të komunave.
5. Mbikëqyrë dhe monitoron implementimin e strategjisë;
6. Koordinon punën e ministrive përgjegjëse;
7. Vendos mekanizmat efikas për shpërndarjen e informacioneve ndërmjet ministrive dhe komunave të përfshira;
8. Koordinon me kuvendet relevante komunale implementimin e strategjisë në nivel të komunave.
9. Do të takohet në baza të rregullta kohore dhe do të informoj qeverinë për të arriturat dhe sfidat e evidentuara gjatë punës së tij, respektivisht gjatë monitorimit të zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit për riintegrimin e personave të riadhesuar.
10. Do të koordinoj aktivitetet e donatorëve/organizatave të cilat janë aktive në zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit.

7.3. Sekretariati i Bordit Koordinues Ndërministror

Bordi koordinues ndërministror për riintegrimin e personave të riadhesuar do të ketë një sekretariat i cili do ta siguroj funksionimin sa më të mirë të këtij bordi. Sekretariati do të përkrah bordin në kryerjen e të gjitha obligimeve që kjo strategji apo aktet tjera relevante e obligojnë atë.

Përbërja e Sekretariatit

Sekretariati do të udhëhiqet nga MPB-ja dhe do të përbëhet nga zyrtarë të ministrive tjera dhe agjencive relevante në nivel qendror. Të gjitha ministritë dhe agjencitë

relevante do të emërojnë një zyrtar i cili do të jetë pikë koordinuese në ministrinë/agjencinë e tyre për procesin e ripranimit dhe riintegrimin, dhe po i njëjti zyrtar do të jetë edhe anëtar i këtij sekretariati. Niveli lokal do të përfaqësohet nga përfaqësuesi i MAPL-së i cili do të jetë pikë koordinimi për të gjitha çështjet që ndërliken me nivelin komunal dhe i/e cili/a do të jetë edhe anëtar i këtij sekretariati.

Përgjegjësitë e Sekretariatit

- Sekretariati do të koordinoj punët e të gjitha institucioneve relevante që merren me ripranim dhe riintegrim, respektivisht do të koordinoj zbatimin e kësaj strategjie dhe planit të saj të veprimit.
- Sekretariati do të monitoroj zbatimin e strategjisë dhe planit të punës dhe do t'i rekomandoj bordit të ndërmerr hapat e nevojshëm me qëllim të sigurimit të riintegrimin sa më të mirë.
- Sekretariati do të përpiloj kërkesat për të marrë mjete nga fondi për riintegrimin e personave të riatdhesuar, këto kërkesa do t'i përpiloj në bazë të kërkesave që do të vijnë nga ministrinë/agjencinë relevante dhe do t'i procedojë më tutje te Bordi ekzekutiv për aprovim.
- Sekretariati do të hartoj raporte periodike, të rregullta, për të gjitha shpenzimet e bëra nga ky fond dhe arsyeshmërinë e tyre.
- Sekretariati do të hartoj raporte periodike, të rregullta, ku do ta informoj Bordin, Qeverinë apo edhe më gjerë për gjendjen reale në teren, do të siguroj informata kuantitative dhe kualitative të cilat do të pasqyrojnë gjendjen reale në teren dhe do të rekomandoj hapat e më tutjeshëm.
- Sekretariati do të takohet gjithmonë para takimit të bordit ekzekutiv ku edhe do të analizoj situatën reale sa i përket riintegrimin të personave të riatdhesuar dhe do të përgatis materialet e nevojshme për takimin e bordit.

7.4. Koordinimi i zbatimit të strategjisë në nivel lokal

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal do të jetë përgjegjëse për koordinimin e këtij procesi me të gjitha komunat e Kosovës dhe me të gjithë akterët tjerë relevantë të cilët veprojnë në nivel komunal.

MAPL do ta rregulloj këtë çështje me një akt të veçantë të cilin do ta nxjerrë me qëllim të përcaktimit sa më të mirë të mekanizmit koordinues në nivel lokal.

ANEKSI 1

KORNIZA LIGJORE DHE INSTRUMENTET NËRKOMBËTARE

1. Dokumentet referuese të Republikës së Kosovës

Në fushën e Reintegrimit, Republika e Kosovës ka një bazë të gjerë ligjore, ku si legjislacion parësor mund të përmendën por nuk kufizohen vetëm në:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës;

Ligji për Shtetësinë,

Ligji për Azil (Nr. 03/L-066),

Ligji për të Huajt (Nr. 03/L-126),

Ligji për Punësimin e të Huajve,

Ligji për Regjistrat Civil,

Ligji për Vendbanim dhe Vendqëndrim.

Ligji për emrin personal;

Projektligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

Ligji për Leternjoftimin;

Ligji për Dokumentet e Udhetimit;

Ligji për Azil;

Ligji për Pronesin

Ligji për librin amzë;

Ligji për krijimin e Regjistrave për të drejten e Prones;

Ligji për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronen e paluejtshme private, duke përfshirë pronen bujqësore dhe ato komerciale;

Ligji për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare,

Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Shëndetësi;

Ligji për kujdesin shëndetsor emergjent;

Ligji për veprimtarin private në shëndetësi;

Ligji mbi pensionin themelor;

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë;

Projektligji për Punën;

Ligji për statusin dhe të drejtat e familjarëve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës;

Kodi Penal i Kosovës;

Kodi i Procedurës Penale;
Ligji per pensionet e Aftesis se Kufizuar,
Ligji per ndryshim dhe plotesimin e Ligjit per Shendetesi;
Ligji per Familjen;
Ligji per sherbimet sociale dhe familjare;
Ligji per edukim parashkollor;
Ligji per shendetesin publike;
Ligji per Mergaten e Kosoves;
Ligji për Arsimin Fillor dhe të Mesëm;
Ligji per inspeksionin e arsimit në Kosovë;
Ligji per arsimin ne komunat e Republikes se Kosoves;
Ligji per arsimim dhe aftesim profesional;
Udhëzimi Administrativ **Nr. 11/2004** për punën dhe kriteret e vendosjes se rezidenteve ne shtëpinë e personave te moshuar dhe pa përkujdesje familjare;
Udhëzimi Administrativ **Nr. 12/2004** për punën dhe vendosjen e rezidenteve ne Institucionin Special në Shtime,
Strategjia Kombetare per Migracion
Strategjia Nacionale kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore;
Strategjia Shendetesore e Kosoves
Strategjia në Parandalimin e Incidenteve në Shkolla.

2. Konventat dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës, që kanë ndikim në mbrojtjen e personave te reintegruar janë:

1. Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut;
2. Konventa e Gjenevës mbi Mbrojtjen e Refugjatëve, 1951; dhe Protokollit të 1967
3. Konventa e Nju Jorkut për Personat Pa Shtetësi;
4. Konventa e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas;
5. Konventa e OKB-së Kundër Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Tjetër Misor, Johuman dhe Poshtërues, 1984;
6. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
7. Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës;
8. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj.

